

**DEKADA E ROMËVE  
DHE SITUATA  
E ROMËVE  
NË SHQIPËRI**

**20  
12**



FONDACIONI  
SHOQËRIA  
E HAPUR  
PËR SHQIPËRINË






# DEKADA E ROMËVE DHE SITUATA E ROMËVE NË SHQIPËRI, 2012

---

TIRANË, 2013

# PERMIT





## **FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË**

*DEKADA E ROMEVE DHE SITUATA E ROMEVE NE SHQIPERI 2012*

### **ADRESA**

*Rr. Qemal Stafa, Pallati 120/2, Tirana, Albania*

*Tel: +355 4 22 34 621/ 22 34 223/ 22 35 856*

*Fax: +355 4 22 35 855*

*E-mail: [info@soros.al](mailto:info@soros.al)*

*Web-page: [www.soros.al](http://www.soros.al)*

### **DESIGN & LAYOUT**

*Henrik Lezi*

## FJALË PËRSHËNDETËSE

Gjendja e komunitetit rom në Shqipëri mbetet e vështirë paçka se vitet e fundit janë angazhuar mjaft fonde dhe ndërhyrje përgjithësisht të mbështetura nga donatorë të huaj. Studime dhe raportime në media dëshmojnë për një situatë të vështirë të komunitetit rom në fusha të tilla jetike si punësimi, strehimi, arsimit dhe shëndeti. Këto analiza tregojnë gjithashtu se kapaciteti koordinues dhe zbatues i institucioneve qendrore dhe vendore është i pamjaftueshëm për tu përballur me shtrirjen dhe thellësinë e problematikave me të cilat ballafaqohet komuniteti rom. Përvoja e zbatimit të politikave të përfshirjes së komunitetit rom në vende të ndryshme sugjeron se përpjekjet për zbutjen apo sheshimin e vështirësive me të cilat përballlet ky komunitet duhet të jenë njëkohësisht specifike por edhe ndërsektoriale pasi shkaqet si dhe problematika duket se ndërthuren pazgjidhshmërisht me njëra tjetrën. Dekada Rome ndihmoi në zhvendosjen e çështjes rome nga periferia e largët në qendër të ligjërimit të institucioneve publike në vende të ndryshme. Sidoqoftë, sukcesi i zbatimit të prioritetëve të dekadës së përfshirjes së romëve varet mësëpaku nga retorika dhe ligjërimi dhe mësëshumti nga emancipimi, vullneti dhe kapaciteti i shoqërive dhe institucioneve për t'iu përmbajtur këtij angazhimi. Në këtë kuadër, duhet patur në konsideratë se politikën dhe programet qeveritare në ndihmë të komunitetit rom zbatohen nga qenie njerëzore të cilat i përkasin përgjithësisht maxhorancës së popullsisë dhe për rrjedhojë opinioni, paragjykimet si dhe më pas qëndrimet e tyre kundrejt komunitetit rom përbëjnë një faktor të rëndësishëm në suksesin apo dështimin e këtij angazhimi.

Studimet janë të domosdoshme në mënyrë që vendimarrja dhe më pas veprimi të orientohen drejtë. Gjithashtu studimet nevojiten për të vlerësuar impaktin dhe nevojën për përmirësim të politikave të caktuara. Nisur nga studime të shumta duket se në opinionin publik ekziston perceptimi se komuniteti rom nuk bën përpjekje të mjaftueshme për tu integruar dhe për të përfituar nga burimet dhe mundësitë që ofron shoqëria shqiptare. Po kështu në komunitetin rom ekziston opinioni që maxhoranca e shoqërisë nuk është e interesuar për të integruar këtë komunitet pasi ajo ushqen paraqyqime të cilat pengojnë gadishmërinë e saj për të bërë një hap përpara në pranimin e komunitetit rom jo thjesht përmes politikave dhe programeve të qeverisë por edhe përmes komunikimit njerëzor, ndërveprimit social dhe bashkëpunimit të hapur në çdo fushë. Ky studim u zhvillua për të kuptuar më shumë rreth zbatimit të planit të veprimit të dekadës rome dhe situatës në të cilën gjendet komuniteti rom në Shqipëri vetëm 3 vjet larg përfundimit formal të këtij angazhimi ndërqeveritar.

Ky studim, duke ndërthurur metodat cilësore dhe ato sasimore depërton thellë si dhe shtrihet në gjerësi për të kuptuar më mirë gjëndjen e komunitetit rom në prespektivën ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe të strehimit, shkallën e kënaqësisë së tyre përkundrejt shërbimeve publike si dhe nivelin e aksesit në marrjen e këtyre shërbimeve. Gjithashtu, ky hulumtim merr në konsideratë disa prej masave specifike të planit të veprimit të dekadës rome, shkallën e zbatimit të tyre dhe masën e financimit përmes buxhetit të shtetit.

ANDI DOBRUSHI  
Drejtor Ekzekutiv

## METODOLOGJIA

Pjesa sasiore e studimit u realizua nëpërmjet një ankete ballë për ballë me persona të komunitetit Rom të përzgjedhur në mënyrë rastësore nëpërmjet një procesi të shtresëzuar kampionimi.

Universi i studimit është popullsia Rome në Shqipëri. Për të percaktuar shtrirjen e këtij “universi” u përdorën të dhëna nga studimi i UNICEF-it “**Mapping Roma Children in Albania 2011**”.

1. Në bazë të të dhënave ekzistuese u krijuan disa rajone me një numër domethënës romësh, prej të cilëve do të dilte më pas kampioni i anketës. Ndarja sipas rajoneve përbën shtresëzimin e parë. Tabela 1.1 me poshtë tregon shpërndarjen sipas këtyre rajoneve.

2. Çdo rajon kishte të dhëna të detajuara për vendbanimet rome, qofshin këto lagje brenda një qyteti apo fshatra të ndryshëm brenda një rajoni. Këto vendbanime përbëjnë pikat bazë të kampionimit për anketën dhe shtresëzimin e dytë të kampionimit. Tabela 1.2 më poshtë tregon shpërndarjen e kampionit të realizuar.

3. Në vendndodhjen me popullsi rome anketuesit kanë realizuar intervistat e tyre bazuar në standartin 1 në 3 dyer. Duke qenë se këto kanë qenë vendndodhje me popullsi relativisht homogjene rome, ka qenë e pamundur të bëhej

**Tabela 1.1**

Rajoni	Nr. Romesh	% ndaj totalit/ % brenda rajonit
Tirane	3780	28%
Durres	965	7%
Elbasan + Peqin+Rrogozhine	1332	10%
Fier	2273	17%
Korce + Pogradec	2139	16%
Berat + Kucove	811	6%
Lushnje	618	5%
Vlore	432	3%
Shkoder +Lezhe+Fushe-Kruje	1352	10%
Total Universe	13702	

Burimi: UNICEF “Mapping Roma Children in Albania 2011

**Tabela 2.2 – Shpërndarja e kampionit**

Rajoni	Nr.	%
Tirane	230	25
Durres	63	7
Elbasan + Peqin+Rrogozhine	83	9
Fier	163	18
Korce + Pogradec	140	16
Berat + Kucove	53	6
Lushnje	26	3
Vlore	30	3
Shkoder +Lezhe+Fushe-Kruje	117	13
Kampioni Total	905	



dallimi midis popullsisë rome dhe asaj egjiptiane. Prandaj një pjesë e të anketuarve ka rezultuar të jenë deklaruar si egjiptianë (rreth 17% e kampionit faktik). Sidoqoftë, nga një analizë e mëtejshme e rezultateve u vu re se nuk rezulton mospërputhje domethënëse, e cila do të sugjeronte një analizë të veçantë.

Anketat u realizuan në terren, në periudhën 21-25 nëntor, 2012.

### Pyetësi

Instrumenti i anketës u hartua në bazë të objektivave të studimit dhe më pas u testua përpara se të përdorej në terren për anketën. Pyetësi ka këto seksione bazë:

1. Moduli i Familjes ( të dhena bazë për të gjithë anëtarët e familjes)
2. Moduli Ekonomik
3. Pjesa Institucionale (aksesi dhe kënaqësia me shërbime të ndryshme)
4. Moduli i Punësimit
5. Moduli i Arsimit
6. Moduli i Shëndetit
7. Moduli Demografik

### Toleranca e gabimit

Toleranca e gabimit për këtë kampion është  $\pm 3.2\%$ , me një interval besimi 95%. Teknikisht, një tolerancë gabimi  $\pm 3.2\%$  nënkupton që, nëse merren në mënyrë të përsëritur kampione të kësaj madhësie, 95% e tyre do të pasqyrojnë opinionet e popullatës me pasaktësi jo më të madhe se  $\pm 3.2\%$ . Kontrolli i rëndësisë statistikore, i cili mban parasysh tolerancën e gabimit, është i rëndësishëm veçanërisht kur paraqitet analiza e rezultateve për nëngrupe. Këto kontrolle statistikore janë zbatuar në rezultatet e paraqitura në këtë raport.

## GJETJET KRYESORE

### Situata ekonomike

- Përgjithësisht, problemet më shqetësuese të komunitetit Rom kanë një natyrë ekonomike dhe lidhen me krijimin e mundësisë për përballimin e një jetese të pranueshme (Papunësia, Mungesa e Ushqimit, Mungesa e kushteteve të jetesës etj.).
- Romët shfaqen pesimistë në lidhje me të ardhmen e afërt ekonomike. Vetëm 15% e tyre mendojnë se gjendja e tyre ekonomike do të jetë më mirë në 2013 se në 2012. Pjesa tjetër ose mendojnë se do të jetë më keq (33%), ose e njëjtë (24%), ose nuk dinë të japin një përgjigje (29%).
- Sipas vetëdeklarimeve, të ardhurat familjare të romët mjaftojnë sa për të siguruar mbijetesën e anëtarëve të familjes dhe në një pjesë të konsiderueshme nuk arrijnë as të permbushin këtë funksion.
- Të ardhurat nga aktivitete joformale si grumbullimi dhe shitja e kanaçeve përbëjnë burimin kryesor të jetesës për 40% të familjeve rome. Nëse përfshijmë këtu edhe ata që deklarojnë si burim kryesor jetese punësimin në sektorin privat informal (10%), si edhe ata që deklarojnë si burim kryesor punësimin e rastit (punë me ditë, 11%), atëherë rezultojnë se për 61% të familjeve rome të ardhurat nga sektorët informalë përbëjnë burimin kryesor të jetesës.
- Në lidhje me shërbimet publike romët janë:
  - Të ndarë për sa i takon Shëndetësisë. Rreth gjysma e Romëve të pyetur janë të kënaqur me Shërbimin Shëndetësor, ndërsa gjysma tjetër është e pakënaqur.
  - relativisht të kënaqur për sa i përket arsimit parauniversitar. Rreth 56% e Romëve të intervistuar, që janë pjesë e familjeve me fëmijë në moshë shkollore, shprehin të kënaqur, ndërsa rreth 28% shprehin të pakënaqur.
  - Të pakënaqur kundrejt sistemit të “përkrahjes sociale”. Një pjesë prej 34% u shprehën se janë “të pakënaqur” me këtë shërbim, si dhe 47% të tjerë të cilët thanë se janë “shumë të pakënaqur”. Vetëm 10% e të anketuarve u përgjigjën se janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me këtë shërbim. Ky nivel pakënaqesie ka të bëjë edhe me aksesin që kanë Romët në sistemin e Ndihmës Ekonomike. Nëse projektohet në të gjithë kampionin, vetëm 21% e përdorin si shërbim, një shifër e ulët nëse krahasohet me 73% të romëve, të cilët deklaruan se sigurojnë me shumë vështirësi vetëm nevojat për ushqim.
  - Të pakënaqur ndaj Zyrave të punës ( rreth 74%). Nga ata që deklarohen si të papunë **vetëm 29% thonë se janë të regjistruar në zyrën e punës.** 71% e të

anketuarve, që janë të papuë dhe që mund të përdorin shërbimet e zyrës së punës, nuk janë të regjistruar në këtë zyrë.

- deri diku të pakënaqur me furnizimin me ujë dhe të pakënaqur në lidhje me kanalizimet e ujrave të zeza (e lidhur kjo natyrisht me kushtet dhe zonat ku banojnë, ku shërbimet publike janë vështiresisht të aksesueshme).
- Vetëm 16% e romëve të intervistuar kanë dëgjuar për programe punësimi gjatë dy viteve të fundit. Pjesa dërrmuese prej 84% nuk ka njohuri për programe të tilla punësimi. Ndër ata që kanë dëgjuar për këto programe është interesante të vihet re se rreth 24% kanë deklaruar se kanë dëgjuar nga OJF të ndryshme, pothuajse njelloj sa ata që deklarojnë se kanë dëgjuar nga zyrat e punës (21%).
- Informimi i komunitetit rom për programe punësimi në punët publike të zbatuara nga njësitë e pushteti lokal (Bashki apo Komuna) është shumë i ulët. (Vetëm 10% kanë deklaruar se kanë dëgjuar për këto lloj programesh). Nëse bëjmë edhe një projektim në lidhje me pjesëmarrjen në këto programe, vetëm mbi ata të anketuar që janë të regjistruar në zyrën e punës, atëherë rezulton se 1 në 13 romë të regjistruar në zyrën e punës ka marrë pjesë në këto programe punësimi të Bashkive apo Komunave.

## Punësimi

- Gjatë periudhës së tranzicionit pasocialist romët kaluan nga punësimi i plotë dhe i garantuar në një papunësi masive dhe afatgjatë. Studimi tregon se aktualisht 42% e romëve (sidomos gratë dhe të rinjtë) janë të papunë dhe ky është edhe problemi më i vështirë me të cilin ata përballen në jetën e tyre të përditshme. Siç tregojnë teknikat e “mystery shopping”, të përdorura gjerësisht në këtë studim, inefikasiteti i institucioneve formale për gjetjen e një vendi pune, etniciteti dhe kapitali i pakët social, kanë çuar në rritjen e pakënaqsisë (74%) nga shërbimi i zyrave të punës. Ndërkaq, thuajse 90% e romëve nuk kanë kontrata pune dhe nuk paguajnë sigurime shoqërore, çka i përjashton ata nga një varg shërbimesh sociale (pagesa e papunësisë, sigurimet shëndetësore, pensionet e pleqërisë etj.) duke rritur kështu pasigurinë e tyre ekonomike afatgjatë.
- Romët deklarojnë disa shkaqe lidhur me nivelin e lartë të papunësisë së tyre. Këto shkaqe lidhen kryesisht me mungesën e mundësive të punësimit për të gjithë në Shqipëri, etnicitetin, nivelin e tyre shumë të ulët arsimor dhe profesional. Kështu, të dhënat tregojnë se 81% e romëve nuk zotërojnë ndonjë profesion, 9% kanë profesione për të cilat kërkesa është në rënie dhe vetëm 6% zotërojnë profesione për të cilat ka një kërkesë në tregun e punës. Ndërkaq, pjesëmarrja e romëve në kurset e trajnimit profesional pa pagesë – si pasojë e mungesës së informacionit, mos-regjistrimit si të papunë dhe mosbesimit se kjo i ndihmon në gjetjen e punës – është e ulët.

- Si pasojë e varfërisë dhe e përjashtimit social nga tregu formal i punës, romët punojnë në tregun informal, kryesisht në mbledhjen e hekurishteve, në tregtinë e rrobave të përdorura, punët e rasti, ndërtim dhe lypje. Këto punë sigurojnë të ardhura të pamjaftueshme dhe të pasigurta për familjet e tyre. Megjithatë, edhe këto të ardhura janë në rënie, çka shkakton një rritje të varfërisë, një stres të fortë emocional dhe prekin sigurinë e ardhshme ekonomike të tyre. Ndërkaq, nëse alternative të reja nuk zhvillohen, romët do të vazhdojnë të jenë edhe në të ardhmen të mbërthyer në kurthin e varfërisë.
- Arsimimi dhe kualifikimi i romëve në përputhje me kërkesat e tregut formal të punës janë dy nga hallkat kryesore që duhen përmirësuar. Krahas kësaj qeveria dhe aktorët e tjerë lokalë duhet të bashkëpunojnë për formalizimin gradual të sektorit informal. Ky proces duhet lehtësuar në mënyrë që kostoja e këtij tranzicioni të jetë e përballueshme për familjet e varfëra rome. Një zgjidhje tjetër interesante do të ishte edhe krijimi i bizneseve sociale në sektorët ku romët kanë një eksperiencë.

### Arsimi

- Në rreth 12% të rasteve romët e anketuar deklarojnë se në zonën ku ata banojnë nuk ekzistojnë mundësitë për arsimim të fëmijëve
- Studimi tregon se rreth 40% e popullatës rome 10 vjeç e lart, si dhe 36% e fëmijëve të grupmoshës 7 deri në 15 vjeç nuk kanë kryer asnjë klasë shkollë
- 30% e familjeve rome që deklarojnë se kanë qoftë dhe një fëmijë në moshë kopshti apo shkolle shprehen se fëmijët e tyre nuk frekuentojnë anjërën prej këtyre institucioneve arsimore
- 31% e familjeve rome deklarojnë se kostoja e arsimimit të fëmijës së tyre është e papërbalueshme për ta. Kjo përqindje përkon me numrin e familjeve rome që deklarohen se fëmijët e tyre në moshë shkolle apo kopshti nuk i frekuentojnë këto institucione
- Të pyetur rreth shpeshësisë së takimeve me mësuesit e fëmijëve të tyre, 46% e prindërve shprehen se nuk e kanë takuar asnjëherë mësuesin e fëmijës së tyre përgjatë vitit 2012
- Paçka se ligji i ri i arsimit parauniversitar i miratuar në qershor 2012 parashikon në nenin 28 detyrimin e buxhetit të shtetit dhe përgjegjësinë administrative të qeverisë vendore për të mbështetur fëmijët pjesë e familjeve në nevojë, të cilët frekuentojnë arsimin parauniversitar, një mbështetje e tillë përgënjeshtrohet nga shumica absolute e familjeve rome pjesmarrëse në studim

### Shëndeti

- Anketa tregon se rreth 50% e romëve të përfshirë në studim nuk zotërojnë librezë shëndetësore, gjë që bart pasojat të shumëfishta në marrjen e shërbimit shëndetësor.
- Rreth 56% e personave të pyetur deklarojnë të kenë shkuar nga 4 deri në 10 herë në qendra shëndetësore apo spitale gjatë vitit 2012. Kjo shifër përbën një tregues domethënës sa i përket shkallës së problemeve shëndetësore, gatishmërisë së komunitetit rom për

të kërkuar shërbim shëndetësor, por nga ana tjetër mund të jetë një sinjal edhe për shkallën e ulët të efikasitetit të shërbimit shëndetësor për të trajtuar dhe zgjidhur në një kohë optimale problemet shëndetësore që prekin këtë komunitet.

- 89% e romëve të përfshirë në studim pranojnë se kërkojnë ndihmën e shërbimit shëndetësor në rast se ata apo një anëtar i familjes përballet me një problem shëndetësor.

### Strehimi


- Vetëm 4% e familjeve rome të përfshira në studim pranojnë të përdorin një prej formave të programeve të strehimit social
- Sipas studimit, 35% e familjeve rome jetojnë në banesa deri në 40 m<sup>2</sup> dhe se 31% e banesave shfrytëzohen nga dy apo më shumë kurora
- 18% e familjeve rome jetojnë në barraka dhe kasolle në kushte jetese mjaft të vështira dhe pa asnjë mundësi për t'u legalizuar, ndërkohë që 50% e familjeve rome deklarojnë se banojnë në shtëpi të vjetra
- Së paku 19% e familjeve rome qëndrojnë mjaft larg nga standardi minimal i sipërfaqes së strehimit i parashikuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 3.12.2004 "Për normat e strehimit"
- Rreth 45% e familjeve rome, të cilat deklarojnë të ardhura mujore familjare më pak se 15,000 lekë, nuk mund të përmbushin kriteret e aftësisë për të paguar me qëllim kualifikimin për të përfituar nga programet sociale të strehimit.

### Analiza e shfrytëzimit të buxhetit të shtetit në zbatimin e Dekadës Rome në Shqipëri

- MPÇSSHB ka bërë përpjekje për të planifikuar produkte specifike për komunitetin rom dhe egjiptian kryesisht në fushën e mbrojtjes sociale dhe monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit të Dekadës (PVD).
- Një pjesë e madhe e masave të planit të veprimit janë parashikuar të zbatohen nga projekte të financuara dhe zbatuara nga donatorë të ndryshëm. Në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) nuk konstatohet që të planifikohet ndërhyrje me financime të qeverisë pas përfundimit të këtyre projekteve.
- Ministrinë e tjera nuk kanë planifikuar sa dhe si duhet produkte të veçanta për komunitetin rom dhe egjiptian në programin buxhetor afatmesëm 2013-2015.
- Ka shumë masa në planin e veprimit që parashikohen të zbatohen me buxhetet që institucionet kanë në dispozicion (të përfshira në kategorinë kosto administrative). Për qëllime të monitorimit dhe raportimit është shumë e vështirë që të vlerësohen fondet e alokuara për këto masa.
- Fondet IPA janë instrumenti që aktualisht kanë mundur financimin e projekteve për komunitetin rom dhe egjiptian. Ky instrument është përdorur nga MPÇSSHB-ja në bashkëpunim me ministri të tjera dhe komunitetin e donatorëve.

# 01 Situata ekonomike


Mungesa e të ardhurave dhe vështirësia e jetesës janë problemet më të mëdha me të cilat përballet komuniteti Rom. Afërsisht një në tre romë përmendin “Papunësinë” si problemin më të vështirë me të cilin ata përballen në jetën e tyre të përditshme. Përgjithësisht problemet më shqetësuese të këtij komuniteti kanë një natyrë ekonomike dhe të krijimit të mundësisë për përbalimin e një jetese të pranueshme...



**50%**  
**e romëve**  
**pranojnë se**  
**papunësia**  
**dhe mungesa**  
**e ushqimit**  
**janë problemi**  
**kryesor në**  
**jetën e tyre**

Mungesa e të ardhurave dhe vështirësia e jetesës janë problemet më të mëdha me të cilat përballet komuniteti Rom. Të intervistuarve iu kërkua të përmendin problemin më të vështirë me të cilin ata përballen në jetën e tyre të përditshme<sup>1</sup>. Afërsisht një në tre romë të intervistuar (36%) përmendën “Papunësinë”. Problemi i dytë në shpeshtësi është “Mungesa e ushqimit”, e përmendur nga 15% e romëve të intervistuar. I treti në renditje paraqitet “Kushtet jo të mira të jetesës” me 11% të respondentëve, i ndjekur në vend të katërt nga “Inflacioni, çmimet e larta dhe kostoja e lartë e jetesës” me 8%. Përgjithësisht problemet më shqetësuese të këtij komuniteti kanë një natyrë ekonomike dhe të krijimit të mundësisë për përballimin e një jetese të pranueshme.

**GRAFIKU 1.1. Cili është problemi më i vështirë me të cilin përballen në jetën tuaj të përditshme? (Në Përqindje)**




Rezultatet tregojnë se perceptimi i gjendjes vetjake ekonomike të romët është i ulët. Një pjesë prej 30% percepton një gjendje ekonomike vetjake të keqe, ndërsa pjesa tjetër prej 35% e vlerëson situatën e vet ekonomike si shumë të keqe. Vetëm një pakicë prej 8% e romëve të intervistuar mendojnë se janë mirë ekonomikisht, dhe më pak se 1% deklarojnë një ekonomi familjare shumë të mirë.

1. Pyetja ishte e hapur dhe respondentët mund të përmendnin çfarëdo shqetësimi të tyre. Për qëllime analize, prblemët e përmendura u kategorizuan në grupe; psh: “Nuk kemi punë” tek “Papunësia” etj.




**GRAFIKU 1.2. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit situatën tuaj ekonomike? (Në Përqindje)**



Shumica e romëve të intervistuar mendojnë se gjendja e tyre ekonomike, krahasuar me një vit më parë, në rastin më të mirë nuk ka pasur ndryshim. Një pjesë prej 44% e të intervistuarve e shohin gjendjen e tyre ekonomike të tanishme, të njëjtë me atë të një viti më parë. Ndërsa një pjesë tjetër prej 43%, mendojnë se ekonomikisht kanë qenë më mirë një vit më parë pasi gjendja e tyre ekonomike ka ardhur duke u përkeqësuar. Vetëm një pakicë prej 12% shohin një ndryshim pozitiv në mirëqënieën e tyre krahasimisht me vitin e kaluar.

**GRAFIKU 1.3. Krahasuar me një vit më parë mendoni se situata juaj ekonomike aktualisht është më e mirë, e njëjtë apo më e keqe? (Në Përqindje)**




Përkeqësimi i gjendjes ekonomike vetjake, sipas mendimit të romëve, do të vazhdojë edhe gjatë vitit të ardhshëm. Një në tre romë të intervistuar (32%) mendon se do të ketë mirëqënie më të ulët përgjatë vitit të ardhshëm krahasuar me vitin 2012. Një pjesë tjetër prej 33% e intervistuarve nuk shohin ndonjë ndryshim të mundshëm të gjendjes së tyre ekonomike, ndërsa 29% nuk janë të qartë se në ç'kah do të shkojë ndryshimi. Vetëm 15% e romëve mendon se në vitin e ardhshëm do të jenë më mirë se ç'janë aktualisht.

**65%**


**e romëve  
pohojnë se  
situata e tyre  
ekonomike  
është e keqe**

Sipas vetëdeklarimeve, të ardhurat familjare të romët mjaftojnë sa për të siguruar mbijetesën e anëtarëve të familjes, dhe në një pjesë të konsiderueshme nuk arrijnë as të përmbushin këtë funksion. Të pyetur se cili nga pohimet do të përshkruante më mirë gjendjen e familjes së tyre, 43% e romëve deklaruan se “kanë aq para sa të mbajnë frymën gjallë”, ndërsa një pjesë tjetër prej 21% shprehen se nuk mund të siguronin ushqimin e mjaftueshëm me të ardhurat aktuale, shtuar edhe një pjesë prej 10% të cilët nuk mund të sigurojnë mjaftueshëm të ardhura për veshje të domosdoshme. Vetëm 22% e qytetarëve romë të intervistuar deklaruan se të ardhurat e tyre familjare ishin të mjaftueshme për të përmbushur nevojat kryesore të jetesës, dhe një pjesë e vogël prej 3% arrin të sigurojë aq të ardhura sa të mbulojë nevojat bazë dhe të kursejë.

**GRAFIKU 1.4. Cila nga fjalitë e mëposhtme do t'i përshtatej më mirë gjendjes aktuale të familjes suaj? (Në Përqindje)**



Sipas anketës një familje rome ka mesatarisht 4.8 anëtarë që është pothuajse 1 anëtar më shumë se mesatarja e vendit<sup>2</sup>. Ndërkohë nga përgjigjet del se rreth 69% e familjeve rome shpenzojnë jo më shumë se 20 000 lekë në muaj, që do të thotë shpenzojnë jo më shumë se 140 lekë në ditë për çdo anëtar të familjes. Nëse të dhënat analizohen më thellë, del se 1 në 4 familje të intervistuar shpenzojnë më pak se 10 000 lekë ose më pak se 70 lekë në ditë për çdo anëtar.




Perceptimi i ulët i romëve rreth gjendjes së tyre ekonomike, pasqyrohet edhe në pozicionim që ata i bëjnë familjes së tyre në një shkallë të krahasueshme me familjet e tjera në Shqipëri. Romët mendojnë për familjet e tyre si më të varfërat në vend. Të pyetur se ku do ta vendosnin familjen e tyre në një shkallë me vlera nga 0 në 10, ku në 0 gjenden njerëzit më të varfër në Shqipëri dhe në 10 njerëzit më të pasur, pothuajse të gjithë romët e intervistuar dhanë një vlerësim jo më të madh se pesë. E shprehur ndryshe, romët kanë një vlerësim shumë të ulët të gjendjes së tyre ekonomike në krahasim me atë të familjeve të tjera shqiptare; edhe romët “me mirëqënie”<sup>3</sup>, përsëri e konsiderojnë vetveten si familje e mesme e varfër. Anketa tregon se tre në katër romë të intervistuar (75%) dhanë një vlerësim më të vogël se katër në shkallën relative të mirëqënies.

2. 3.9 anëtarë për familje sipas rezultateve përfundimtare të Census 2011. Burimi: INSTAT

3. Krahasimisht me vlerësimet e dhëna nga romët e tjerë


Romët e intervistuar u pyetën për burimet e ndryshme që përdor familja e tyre për jetesë. Një familje mund të ketë më shumë se një burim të ardhurash, kështu që shuma e përqindjeve mund të kalojë 100%.

Një në dy familje rome të intervistuar (51%) deklaroi aktivitete joformale si grumbullim dhe tregti kanaçesh, apo muzikën si një formë burimi të ardhurash. Përfshirja në aktivitetet joformale është forma e “punësimit” më e shpeshtë te familjet rome. Punësimi i rastit në sektorin privat (punë me ditë), ndihmë ekonomike dhe pensioni është janë forma burimi të ardhurash për respektivisht 20%, 18% dhe 17% e familjeve të intervistuar. Një pjesë prej 15% e familjeve rome të intervistuar kanë të paktën një anëtar të vetëpunësuar ne sektorin privat formal dhe një pjesë tjetër prej 15% punojnë në të zezë në këtë sektor.



Të ardhurat nga aktivitete joformale si grumbullimi dhe shitja e kanaçeve përbëjnë burimin kryesor të jetesës për 40% të familjeve rome. Nëse përfshijmë këtu edhe ata që deklarojnë si burim kryesor jetese, *punësimin në sektorin privat informal* (10%), si edhe ata që deklarojnë si burim kryesor *punësimin e rastit* (punë me ditë, 11%), atëherë **rezulton se për 61% të familjeve rome të ardhurat nga sektorët informalë përbëjnë burimin kryesor të jetesës.** Nje pjesë tjetër prej 18% e sigurojnë jetesën nga pensionet (pleqërie apo invaliditeti; 12%), ose nga asistenca apo ndihma ekonomike (6%). Këto

burime, për nga vetë atyra e tyre, nuk mund të jenë të mjaftueshme për të siguruar kushtet bazë të jetesës. **Vetëm 17% e romëve deklarojnë si burim kryesor jetese punësimin në sektorin formal** (11% vetëpunësim në sektorin formal, 3% të ardhurat nga punësimi në sektorin privat formal.)




Më tej të anketuarit u pyetën për nivelin e tyre të kënaqësisë me shërbimet e ofruara nga institucionet publike. Vlerësimet u dhanë një një shkallë me vlera nga 1 në 4, ku 1 do të thotë “Shumë i/e kënaqur” dhe 4 do të thotë “Shumë i/e pakënaqur”.

Komuniteti rom është i ndarë në lidhje me shërbimin shëndetësor në vend. Një pjesë prej 48% janë të kënaqur me sistemin shëndetësor, ndërsa 50% shprehën pakënaqësi. Përsëri, përqindja e romëve shumë të kënaqur me këtë shërbim është vetëm 6%, krahasuar me 20% të cilët janë shumë të pakënaqur.

Rreth 47% e romëve të intervistuar deklaruan se janë ose të kënaqur (6%) ose shumë të kënaqur (41%) me cilësinë e arsimit parashkollor/parauniversitar të ofruar. Nëse shikojmë vetëm ato familje që kanë fëmijë në shkollë, atëherë kënaqësia me cilësinë e arsimit është edhe më e madhe, rreth 56%.


**45%**  
e romëve  
pohojnë se  
situata e tyre  
ekonomike  
është  
përkeqësuar  
krahasuar me  
vitin 2011

**GRAFIKU 1.8. Sa të kënaqur jeni me shërbimin shëndetësor (Në Përqindje)**




Romët kanë pakënaqësi të theksuara kundrejt përkrahjes sociale të ofruar. Një pjesë prej 34% u shprehën se janë te pakënaqur me këtë shërbim, kurse 47% të tjerë thanë se janë shumë të pakënaqur. Vetëm 10% e te anketuarve u përgjigjën se janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me këtë shërbim.

**GRAFIKU 1.9. Sa të kënaqur jeni me përkrahjen sociale (Në Përqindje)**



Pakënaqësia e romëve vërehet edhe ndaj shërbimeve të ofruara nga zyra e punës. Përqindja e romëve të pakënaqur me shërbimet e ofruara nga ky institucion është e lartë - 74%. Kjo shifër është pothuajse shtatë herë më e madhe se përqindja e romëve të cilët janë të kënaqur me këtë institucion (12%). Natyrisht, kënaqësia me shërbimet e ofruara nga zyra e punës nuk mund të jetë e lartë në një vend me papunësi të madhe, pavarësisht origjinës që ka kërkuesi i punës (vjen nga komuniteti rom apo nga maxhoranca e popullsisë). Gjithsesi, ky është një tregues se sjellja e komunitetit rom ndaj kësaj zyre mund të ndikohet drejtpërsëdrejti nga kënaqësia që shpreh për shërbimet që ajo ofron.




Ndryshe nga shërbimet e përkrahjes sociale dhe ato të ofruara nga zyra e punës, komuniteti rom është përgjithësisht i kënaqur me institucionin e gjendjes civile. Përqindja e të intervistuarve rom të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga ky institucion është 67%. Gjithsesi, mbetet shqetësim që rreth 27% e romëve të anketuar deklarojnë se janë të pakënaqur me këtë zyrë. Duhet pasur parasysh se shumë nga procedurat dokumentuese që u duhen familjeve romë për të përfituar nga aksesit në shërbime të ndryshme publike (arsim, asistencë sociale, punësim, strehim etj.) fillojnë te kjo zyrë.

**63%**  
e romëve  
pohojnë se  
të ardhurat  
familjare nuk  
mjaftojnë  
as për tu  
ushqyer

Po ashtu, romët janë përgjithësisht të kënaqur me rendin publik në vend. Për qindja e atyre të anketuarve që janë të kënaqur është dy herë më e madhe se ajo e atyre të pakënaqur, respektivisht 61% dhe 30%.

Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm komuniteti rom është përsëri realtivisht i ndarë. Ndërsa 47% e të anketuarve shprehën kënaqësi ndaj këtij shërbimi, 52% tregojnë se ishin të pakënaqur. Përsëri për qindja e atyre që janë “shumë të pakënaqur” me furnizimin me ujë të pijshëm është 34%, shumë më e lartë se për qindja prej 10% e të anketuarve që ndihen “shumë të kënaqur”.




Romët shprehën se janë më tepër të pakënaqur sesa të kënaqur në lidhje me kanalizimin e ujërave të zeza. Për qindja e të pakënaqurve ndaj këtij shërbimi është 60%, krahasuar me 39% të cilët shprehën kënaqësi. Për t'u vënë në dukje është për qindja e konsiderueshme e respondentëve (39%) të cilët kanë “shumë pakënaqësi” në lidhje me këtë shërbim.

Përsëri romët janë më tepër të pakënaqur sesa të kënaqur si me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave, ashtu edhe me atë të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve. Mbi 60% e të anketuarve deklarojnë pakënaqësi me këto dy shërbime. Për të dyja këto shërbime për qindja e të anketuarve “shumë të pakënaqur” i kalon 40%, krahasuar me pjesën e cila është shumë e kënaqur me këto shërbime, rreth 4-5%.



**GRAFIKU 1.12. Sa të kënaqur jeni me infrastrukturën e kanalizimeve të ujërave të zeza (Në Përqindje)**




Duke pasur parasysh se romët e intervistuar vijnë nga vendbanime relativisht homogjene (të përbëra nga familje rome) atëherë mund të konkludohet se këto janë shërbime që ose mungojnë, ose çalojnë shumë në cilësi në këto vendbanime.

Vetëm një pjesë prej 26% e të anketuarve romë është e regjistruar në zyrën e punësimit. Është interesante të shihet tabela e mëposhtme:


	A jeni I regjistruar ne Zyrën e Punes			Total Nr.
	Pa përgjigje	PO	JO	
I punësuar në sektorin privat	0.0%	25.9%	74.1%	54
I vetëpunësuar në aktivitete të tjera	1.5%	32.2%	66.3%	205
I papunë	0.6%	28.8%	70.7%	351
Shtëpiake	1.6%	22.1%	76.2%	122
Pensionist (merr pension & Invaliditeti)	0.0%	9.4%	90.6%	53
	0.8%	26.3%	73.0%	785

Nga ata që deklarohen si të papunë **vetëm 29% thonë se janë të regjistruar në zyrën e punës**. 71% e të anketuarve që janë të papunë dhe që mund të përdornin shërbimet e zyrës së punës nuk janë të regjistruar në këtë zyrë.

Nëse do të përfshihen edhe anëtarë të tjerë të familjes, të dhënat tregojnë se 31% e familjeve romë kanë të paktën një anëtar të regjistruar në Zyrën e Punësimit.



Vetëm 8% e romëve të intervistuar kanë ndjekur ndonjëherë ndonjë kurs trajnimi për të marrë zanat. Kjo është një shifër shumë e vogël, ndërkohë që rreth 81% e romëve në moshë madhore kanë deklaruar se nuk kanë asnjë zanat.




Vetëm 16% e romëve të intervistuar kanë dëgjuar për programe punësimi gjatë dy viteve të fundit. Pjesa dërrmuese prej 84% nuk ka njohuri për programe të tilla punësimi.

Ndër ata që kanë dëgjuar për këto programe është interesante të vihet re se rreth 24% kanë deklaruar se kanë dëgjuar nga OJF të ndryshme, pothuajse njëloj sa ata që deklarojnë se kanë dëgjuar nga zyrat e punës (21%). Media është një burim i rëndësishëm informacioni sipas përgjigjeve të të anketuarve, pasi 34% e tyre e deklarojnë atë si burimin nga kanë dëgjuar për këto programe.

Informimi i komunitetit rom për programe punësimi në punët publike të zbatuara nga njësitë e pushteti lokal (Bashki apo Komuna) është shumë i ulët. Vetëm 10% kanë dëgjuar për mundësi të këtilla të ofruara nga pushteti vendor. Pjesa tjetër, prej 90%, deklaroi se nuk ishte në dijeni të këtyre mundësive gjatë dy viteve të fundit.

Nga ata, të cilët janë të informuar, vetëm një në katër është punësuar në programet e Bashkive apo Komunave, dhe përgjithësisht në pastrim apo gielbërim. Nëse kjo shifër projektohet në gjithë kampionin, afërsisht vetëm 2% e të anketuarve ka marrë pjesë në punët publike të zbatuara nga njësitë vendore. Nëse bëjmë edhe një projektim tjetër, vetëm mbi ata te anketuar që janë të regjistruar në zyrën e punës, **del se 1 në 13 romë të regjistruar në zyrën e punës ka marrë pjesë në këto programe punësimi të Bashkive apo Komunave.**

**40%**  
e familjeve  
rome kanë  
si burim  
kryesor të të  
ardhurave  
mbledhjen e  
mbetjeve të  
riciklueshme



Komuniteti rom, edhe pse nevojtar, në përgjithësi ka akses të ulët në asistencën ushqimore. Vetëm 29% e romëve të intervistuar pohojnë se ekziston ndihma në ushqime në zonën ku banojnë. Pjesa më e madhe prej 61% janë të bindur që ndihmë të tillë nuk ka në zonën e tyre, dhe pjesa tjetër prej 10% nuk e dinë nëse jepen ndihma në ushqime apo jo.


Fatkeqësisht, vetëm 13% e romëve, të cilët pohojnë se ekziston ndihma në ushqime në zonën ku jetojnë, e përfitojnë këtë ndihmë. Nëse llogaritet për gjithë kampionin, **vetëm 4% e romëve të intervistuar marrin asistencë në ushqime**. Pjesa tjetër e romëve, të cilët janë në dijeni të asistencës në zonën ku banojnë, por nuk e përfitojnë, deklarojnë se ka një pengesë nga institucionet në shpërndarjen e kesaj asistence. 77% e këtij grupi u shpreh që ndihma në ushqime “nuk u jepet”. Kjo pengesë e perceptuar mund të ndikojë në nivelin e kenaqësisë së këtij komuniteti ndaj institucioneve të caktuara.

**74%**  
**e romëve janë**  
**të pakënaqur**  
**nga zyrat e**  
**punës**

Zyra e Punësimit ka një akses mesatar nga komuniteti rom. Një pjesë prej 41% e respondentëve romë pohuan se gjendet një zyrë punësimi në zonën ku ata jetojnë. Një pjesë tjetër prej 50% besojnë që nuk ekziston një institucion i tillë për zonën e tyre, ndërsa 9% nuk e dinë nëse ka apo jo një institucion për punësimi. Ekzistenca e një zyre punësimi në afërsi të zonës ndikon pak në përdorimin e saj. Vetëm 16% e romëve, të cilët janë në dijeni të një zyre punësimi në zonën ku jetojnë, përdor shërbimet e ofruara nga ky institucion. Nëse projektohet në kampionin e plotë, kjo shifër është në një nivel të ulët prej 7%. Arsyeja më e përmendur e mospërdorimit të këtij lloji shërbimi është perceptimi i romëve se ky lloj shërbimi nuk ju ofrohet.

Ndryshe nga asistencë ushqimore dhe ajo për punësim, ndihma ekonomike ka një njohje më të gjerë në këtë komunitet. Kjo tregon një nivel më të pranueshëm aksesit të këtij shërbimi. Më shumë se gjysma (59%) e të intervistuarve romë, janë në dijeni të ekzistencës të këtij institucioni në zonën ku banojnë. Pjesa tjetër prej 37% mendojnë se nuk ka institucione që ofrojnë shërbim të tillë në zonën e tyre. Përsëri, fakti i ekzistencës së këtij shërbimi ndikon pak në përdorimin e tij nga komuniteti rom. Sipas të intervistuarve përdorimi i pakët i Ndhmës Ekonomike (edhe pse nevoja është e madhe) rrjedh nga fakti se institucionet nuk e japin atë për romët. Edhe pse Ndhmë Ekonomike performon më mirë, krahasimisht me shërbimin e ndihmës në ushqime apo Zyrës së


Punësimi, niveli i ndikimit në komunitetin rom është i ulët. Nëse projektohet në të gjithë kampionin, vetëm 21% e përdorin si shërbim; shifër e ulët nëse krahasohet me 73% të romëve të cilët deklaruan se sigurojnë me shumë vështirësi vetëm nevojat për ushqim.



# 02 Punësimi i romëve

Tranzicioni pas socialist drejt ekonomisë së tregut u shoqërua me mbylljen dhe zvoglimin e aktivitetit të ndërmarrjeve shtetërore.

Rrjedhimisht romët kaluan nga punësimi i plotë dhe i garantuar në një papunësi masive dhe afatgjatë. Në fillim të viteve '2000 kjo papunësi vlerësohej në 71%. Ndërkaq, përshtatja e romëve me kërkesat e tregut të punës, ka qenë e vështirë, si pasojë e nivelit të tyre të ulët arsimor e profesional, kapitalit të pakët social, disa formave të diskriminimit dhe përjashtimit social



Të dhënat e anketës tregojnë se problemi më i vështirë me të cilin përballen romët në jetën e tyre të përditshme është papunësia (36%). Aktualisht 42% e romëve janë të papunë dhe kjo papunësi është afatgjatë. Si pasojë e varfërisë dhe përjashtimit social nga tregu formal i punës, romët punojnë në sektorin informal, kryesisht në mbledhjen e hekurishteve, shitjen e rrobave të përdorura dhe punët e rastit. Këto punë të pakualifikuara në sektorin informal sigurojnë të ardhura të pakta dhe të pasigurta në perspektivë për familjet e tyre. Kjo gjë kontribuon në rritjen e varfërisë, stresit emocional dhe prek sigurinë ekonomike afatgjatë të familjeve rome.

### Papunësi masive dhe afatgjatë

Tranzicioni pasocialist drejt ekonomisë së tregut u shoqërua me mbylljen dhe zvoglimin e aktivitetit të ndërmarrjeve shtetërore, si pasojë e reformave drastike të ristrukturimit dhe privatizimit. Rrjedhimisht romët kaluan nga punësimi i plotë dhe i garantuar në një papunësi masive dhe afatgjatë. Në fillim të viteve '2000 kjo papunësi vlerësohej në 71%<sup>4</sup>. Ndërkaq, përshtatja e romëve me kërkesat e tregut të punës, ka qenë e vështirë, si pasojë e nivelit të tyre të ulët arsimor e profesional, kapitalit të pakët social, disa formave të diskriminimit dhe përjashtimit social. Të dhënat e anketës tregojnë se aktualisht 42% e romëve në moshë pune (grup-mosha 18 deri 65 vjeç) janë të papunë, ndërsa 35% pohojnë se punojnë. Shumica e atyre që punojnë janë të vetëpunësuar në aktivitete të tjera (22%), në sektorin privat (7%), të vetëpunësuar në bujqësi (4%) dhe në sektorin publik (2%). Të tjerët janë gra shtëpiake (14%), nxënës, pensionistë etj. Ndërkaq, papunësia është shumë më e lartë se niveli zyrtar i papunësisë në Shqipëri, i cili në vitin 2012 vlerësohet në 13.3%<sup>5</sup> dhe, për më tepër, paraqitet si papunësi afatgjatë.

Të dhënat e anketës tregojnë se në disa qarqe të vendit, si në Lezhë, Shkodër, Korçë, Elbasan dhe Durrës, niveli i papunësisë të romët është mbi mesataren (figura 2). Kjo papunësi masive ka krijuar xhepa të varfërisë dhe, siç do të shikojmë, vatra të migrimit të brendshëm. Ndërkaq, papunësia është më e lartë te gratë, të paarsimuarit dhe të rinjtë e grup-moshës 18 deri 24 vjeç.




**81%**  
*e romëve në moshë pune nuk zotërojnë asnjë zanat*

4. De Soto H., Beddies S., Gedeshi I., and Egyptians in Albania: From social exclusion to social inclusion, The World Bank, Washington D.C., 2005.

5. INSTAT, 2012




**GRAFIKU 2.1. Figura 1. Disa tregues të forcës së punës (grup-mosha e popullsisë rome 18 deri 65 vjeç) (Në Përqindje)**



Burimi: Anketa e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - Soros, 2012

**GRAFIKU 2.2. Papunesia e komunitetit rom sipas qarqeve (Në përqindje)**



Burimi: Anketa e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - Soros, 2012

**55%**  
e popullatës  
rome e aftë  
për punë  
deklarohet e  
papunë

Pavarësisht nga nivelet e larta të papunësisë, 73% e romëve të papunë të anketuar dhe 76% e pjestarëve të familjeve të tyre thonë se nuk janë regjistruar si të papunë në zyrat e punës. Kjo tregon nivelin e ulët të besimit të romëve ndaj institucioneve formale të punësimit për gjetjen e një vendi pune në sektorin formal. Sipas të dhënave të anketës, thuhet se 40% e romëve shprehen se janë “shumë të pakënaqur” dhe 34% “të pakënaqur” nga shërbimi i zyrave të punës. Shkaku kryesor është inefikasiteti në gjetjen e një vendi pune për njerëzit në nevojë ekonomike ekstreme. Shembujt e mëposhtëm, të siguruara nga shfrytëzimi i teknikës së “mystery shopping”<sup>6</sup>, në kuadër të këtij monitorimi, tregojnë perceptimin e romëve për institucionet formale të punësimit.

Tre pjestarë të komunitetit rom dhe tre të popullsisë në shumicë u paraqitën si punëkërkuar në periudhën nëntor - dhjetor 2012 në zyrat e punës të qytetit të Tiranës. Pjestarët e popullsisë në shumicë raportojnë se u pritën mirë nga nëpunësit, të gjithë u regjistruan menjëherë si të papunë dhe secilit i ofruan disa vende pune (si recepsionist në hotele, ndihmësbanakiere, call center etj.). Ndërsa pjestarët e komunitetit rom raportojnë se nuk u regjistruan menjëherë si të papunë dhe nuk u ofruan mundësi reale punësimi. Nurja, një e papunë rome me arsim fillor, tregon eksperiencën e saj në zyrën e punësimit: “Kur vajta në zyrën e punës, ata nuk u sollën dhe aq mirë me mua. Të tjerët (pjestarët e popullsisë në shumicë (shënimi ynë) i pritën mirë, por mua jo. Më pyetën se për çfarë ke ardhur (...) U tregova se isha në një gjendje shumë të vështirë ekonomike dhe doja një vend pune për të ushqyer familjen. Pastaj më pyetën çfarë moshe kam dhe për shkollën. Por nuk më kërkuan kartën e identitetit dhe as numrin e telefonit si të tjerëve. Vetëm më thanë “hajde javën tjetër”. (...) Unë shkova përsëri javën tjetër, por nuk ishte personi që fola, ishte një tjetër. Më pyetën përsëri për moshën, çfarë pune kisha bërë më parë dhe më kërkuan kartën e identitetit dhe numrin e telefonit. Kësaj radhe besoj se më regjistruan (...) Por përsëri më thanë që “nuk ka punë tani, por hajde javës tjetër ose do të të lajmëojmë ne”. (...) Si person në nevojë unë vajta përsëri javën tjetër (...). Personi që më priti më tha se “kam një vend pune për ty, është këtu afër te komunalja dhe jam i sigurt se do të të pranojnë atje. Por ndoshta kjo punë nuk bën për ty”. Ishte fjala për pastruese me fshesë në rrugë. Dhe përsëriti “hajde prapë javës tjetër se mos të gjejmë një punë që të përshtatet ty” (...) Ndjesia ime ..., nuk e di, por u ndjeva sikur ata talleshin me mua, sikur loznin me mua. Thoshin “shko e hajde javës tjetër”, ose që “kam punë, por nuk bën për ty”.

6. *Mystery shopping është një teknikë që përdoret gjerësisht nga bizneset për të provuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve. Kjo teknikë konsiston në përgatitjen e disa personave, të cilët, bazuar në një skenar të mirëpërcaktuar, vizitojnë institucione të ndryshme për të marrë shërbimin përkatës. Vizita në institucione ofron mundësinë e mbledhjes së të dhënave mbi lehtësinë e aksesit të shërbimit, procedurat e ndjekura dhe rolin e punonjësve bazuar në përvoja të drejtëpërdrejta.*

Aktualisht në Shqipëri veprojnë edhe disa agjenci private punësimi, të cilat mundësojnë gjetjen e një vendi pune kundrejt pagesës. Por mundësia e gjetjes së punës nëpërmjet tyre për romët është thujse zero. Mondi, një djalë i ri rom me arsim të mesëm, tregon: “Unë shkova në një agjenci private punësimi dhe kërkova punë. Më ndaluan të dera, më kërkuan “me mirësjellje” CV-në dhe një numër telefoni. Sapo të gjejmë punën, do t’ju lajmërojmë, më thanë kur më përcollën. Por deri tani nuk më kanë telefonuar”.

Të njëjtën histori tregon edhe Mimoza, një vajzë rome me arsim fillor. Ajo tregon: “Në agjencinë private të punësimit më pyetën se kush më kishte dërguar, u interesuan për arsimimin, eksperiencën e punës dhe nëse kisha bërë ndonjë kurs profesional. Pasi u dhashë përgjigje, më thanë se “na vjen keq, po nuk të ndihmojmë dot”.

Një mundësi tjetër është edhe gjetja e punës nëpërmjet ofertave në gazeta<sup>7</sup>. Por edhe këtu eksperiencën është negative. Të rinjtë romë që tentuan të lidheshin me sipërmarrësit që kërkonin punë raportuan raste pak a shumë të njëjta. Një pjesë e numrave telefonikë dilnin të padisponueshëm ose kur kontaktonin, përgjigja ishte “vendi sapo është zënë nga një tjetër para jush”.

Është e njohur se në Shqipëri shumë individë gjejnë punë jo nëpërmjet institucioneve formale (zyrave të punës ose agjensive private të punësimit), por kryesisht nëpërmjet kapitalit të pasur social. Por romët duke banuar në zona periferike rurale ose urbane, të segreguara ose të izoluara, e kanë të vështirë të krijojnë rrjete sociale me popullsinë në shumicë. Kjo mungesë e kapitalit social kufizon mundësitë e punësimit në sektorin formal. Rrjedhimisht, shumë romë mbështeten në kapitalin e kufizuar social, brenda komunitetit të tyre, dhe kërkojnë punë në sektorin informal.

### **Përfitime të pakta nga skema e sigurimeve shoqërore**

Një studim i UNDP<sup>8</sup>-së tregoi se vetëm 0.7% e familjeve rome përfitojnë pagesë papunësie. Kjo shpjegohet me dy arsye kryesore. E para, ndër to është se shumica e romëve punojnë pa kontratë pune në sektorin privat<sup>9</sup> ose nuk kanë mundësi të paguajnë sigurime shoqërore kur punojnë si të vetëpunësuar. Ndërkaq, të dhënat e anketës të organizuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - Soros tregojnë se më shumë se 2/3 e romëve punojnë në sektorin informal. Rrjedhimisht, ata janë të përjashtuar

---

7. Kryesisht gazeta “Çelësi”

8. UNDP., *Needs Assessment Study on Roma and Egyptians Communities in Albania*, 2012

9. Sipas studimit të UNDP, 95.9% e romëve

nga disa shërbime sociale (pagesa e papunësisë, sigurimet shëndetësore, pensioni i pleqërisë etj.), gjë që prek sigurinë e tyre ekonomike afatgjatë. Së dyti, pagesa e papunësisë afrohet në Shqipëri vetëm për 1 vit, ndërsa shumë nga të papunët romë janë afatgjatë. Studimi i UNDP-së tregoi se 39% e të papunëve romë kanë më shumë se 1 vit që janë të papunë.


### Trainimi profesional

Si pasojë e varfërisë dhe përjashtimit social niveli arsimor dhe kualifikimi profesional i romëve është përkeqësuar gjatë tranzicionit pasocialist dhe është ulur në krahasim me popullsinë në shumicë<sup>10</sup>. Rrjedhimisht romët e kanë të vështirë të përshtaten me kërkesat e reja të tregut të punës (ndërsa mundësitë e punësimit do të vazhdojnë të kufizohen në punë të pakualifikuara, me të ardhura të ulta dhe pasiguri të lartë). Të dhënat e anketës tregojnë se 48% e romëve në moshë pune janë analfabetë dhe 27% kanë vetëm arsimin fillor. Ndërkaq, 81% e romëve thonë se nuk zotërojnë ndonjë profesion (figura 3). Disa të tjerë (9%) zotërojnë profesione (punime të thuprës, muzikant, rritës/tregtar kuajsh, punime të hekurit) për të cilat nuk ka kërkesë në tregun e punës ose ajo është në rënie. Vetëm rreth 6% e romëve zotërojnë disa profesione (hidraulik, murator, bojaxhi, elektrikist, xhenerik) për të cilat ka një kërkesë në tregun e punës. Rrjedhimisht trajnimi i romëve me profesione të reja, sipas kërkesave të tregut të punës, është i domosdoshëm.

Gjatë zbatimit të metodës së “*mystery shopping*” gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2012, dy pjesarë të komunitetit rom dhe dy të popullsisë në shumicë u paraqitën në Qendrat e Formimit Profesional në Tiranë dhe kërkuan të regjistroheshin në kurset profesionale. Kurset e trajnimit profesional për romët janë pa pagesë. Arbeni, një rom nga Tirana, tregon eksperiencën e tij: “Në Qendrën e Formimit Profesional unë pyeta për kurset që zhvillojnë. Në zyrën e informacionit më thanë se ka kurse për hidraulik, panele diellore dhe diçka tjetër. Unë kërkova për hidraulik, por më thanë se kursi fillonte pas tre muajsh. Atëhere kërkova për panele diellore. Kursi kushtonte 40.000 lekë, por kur u thashë se jam rom, u përgjigjën se është falas. Më kërkuan që të marr një vërtetim nga ndonjë shoqatë rome, më morën shënim emrin, numrin e celularit dhe më thanë që të filloja që nesër”.


10. Në periudhën parasocialiste romët merreshin me bujqësi (kryesisht meckarët), tregtinë e kuajve, punime të thuprës dhe muzikë. Gjatë periudhës socialiste romët ishin të punësuar në bujqësi, ndërmarrje artistike dhe pyjore, shërbime komunale, etj.

**GRAFIKU 2.3. Lloji i profesioneve në komunitetin rom (Në përqindje)**



Pavarësisht se kurset e trajnimit profesional ofrohen falas për romët e regjistruar si të papunë, ata kanë përfituar shumë pak nga këto lehtësira. Të dhënat e anketës tregojnë se rreth 80% e romëve nuk kanë përfituar nga trajnimet profesionale pa pagesë të ofruara nga qendrat e formimit profesional, kurse rreth 8% thonë se kanë përfituar. Një studim i UNDP-së (2012) tregoi se shumica e romëve thonë se arsyeja kryesore që nuk kanë përfituar është “mungesa e informacionit” (65%), “nuk janë të regjistruar si të papunë” (14%) në zyrat e punësimit dhe se “nuk besojnë se kjo do të ndihmojë në punësimin” (11%) e tyre<sup>11</sup>. Ndërkaq, disa intervista të realizuara me romë tregojnë se të gjithë ata që kanë përfunduar kurset profesionale për hidraulik, panele diellore, shtrim pllakash, rrobaqepësi, parukeri, etj. nuk kanë gjetur punë. Bujari, një rom nga vendbanimi i Azotikut në Fier, tregon eksperiencën e tij: “Ne ishim 10 të rinj romë që përfunduam kursin për hidraulik. Kemi muaj që e kemi përfunduar kursin, por deri më sot asnjëri nga ne nuk ka mundur të gjejë punë as në privat, as në shtet (...) Të tjerë kanë bërë kurse për rrobaqepësi dhe për pllakashtrues. Por edhe ata pa punë janë. Deri tani në kurse profesionale kanë qënë mbi 30 veta dhe asnjë nuk është rregulluar në punë”.

11. UNDP., *Needs Assessment Study on Roma and Egyptians Communities in Albania*, 2012



Burimi: Anketa e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - Soros, 2012

Mungesa e punësimit sipas profesionit demotivon shumë të rinj të ndjekin kurset profesionale. Hasani, një lider rom nga Azotiku i Fierit, jo pa ironi thotë: “Kursi u vlejti shumë, por jo për të siguruar të ardhura për shtëpinë”.

Në raste të tjera kurset e ofruara nuk përputhen me nevojat e tregut të punës dhe që në fillim është e qartë se personat e trajnuar nuk do të gjejnë dot punë. Kështu në Gjirokastrë rreth 15 vajza rome trajnohen për parukiere, kur kërkesat e tregut lokal në atë zonë janë thuajse inekzistente.

### Perceptimet lidhur me shkaqet e papunësisë

Romët japin disa shkaqe lidhur me nivelin e lartë të papunësisë së tyre. Sipas studimit të UNDP<sup>12</sup>-së këto shkaqe lidhen kryesisht me mungesën e mundësive të punësimit për të gjithë në Shqipëri (50%), nivelin e ulët arsimor (19%), etnicitetin (16%) dhe me mungesën e aftësive profesionale (3%).

Perceptimet e romëve lidhur me diskriminimin dhe përjashtimin social

12. UNDP., *Needs Assessment Study on Roma and Egyptians Communities in Albania*, 2012

nuk janë të pabazuara. Sokoli, një nëpunës i zyrës së punësimit në Tiranë, tregon: “Para dy muajsh dërgova në një nga restorantet e qendrës së Tiranës një vajzë rome të arsimuar dhe me eksperiencë. Por nuk e pranuan. Kur pyeta për shkakun e mospranimit më lanë të kuptoja se restoranti është luksoz dhe nuk mund të punësojë si ndihmëse në kuzhinë persona nga ky komunitet”.

Këto forma të diskriminimit i ndesh thua jse në të gjitha aktivitetet prodhuese. Ylli, një rom nga fshati Adriatik i Lezhës, tregon: “Ne jemi ekonomikisht më dobët se të tjerët. Nëqoftëse vjen tek unë, do të shikosh që edhe shalqinin nuk na e marrin ne romëve. Ky është një diskriminim”.


Gjatë zbatimit të “*mystery shopping*” dy vajza të reja, - Flutura dhe Linda - e para nga komuniteti rom dhe tjetra nga popullsia në shumicë, u paraqitën në dyert e një restoranti në Tiranë që kërkonte, nëpërmjet njoftimit në gazetën “Çelësi”, një pjatlarëse. Në fillim shkoi Jeta, e cila la një takim me pronarin/ menaxherin, pasi i telefonoi. Jeta tregon: “Unë i tregova për nevojën për punë (...) Por përgjigja ishte e shpejtë dhe e prerë: “Nuk kam punë për ty, më vjen keq.” Gjysmë ore më vonë shkoi Linda, e cila u pranua në punë.”

Në raste të tjera punëmarrësit nxjerrin për romët ‘pengesa’, të cilat përdoren si pretekst për t’i shmangur butësisht nga pretendimi i vendit të punës. I tillë është rasti i Gimit, një rom me arsim të mesëm nga Tirana, i cili bashkë me Arianin, një bashkëmoshatar nga popullsia në shumicë, u paraqitën për punë në një firmë për reklama. Gimi tregon eksperiencën e tij: “Më pritë në zyrën e saj një grua, e cila u tregua e sjellshme. I tregova se isha i gatshëm të punoja sipas kërkesave të paraqitura në gazetë dhe se zotëroja edhe patentën e makinës në rast se do të ishte e nevojshme. Por më pyetën nëse dija të saldoja, profesion që unë nuk e zotëroj. Më thanë se kësaj radhe kishin nevojë për një punëtor që di të saldojë. Pas kësaj u largova”. Ndërsa Ariani, i cili u paraqit pak më vonë, tregon: “Më pyetën edhe mua, por zotërimi i profesionit të saldimit nuk u paraqit si kusht i domosdoshëm. Bile unë mendoj se ishin të gatshëm të më punësonin”.

## Sektorët e punësimit

Të dhënat e anketës tregojnë se 94% e romëve punojnë në sektorin privat të ekonomisë dhe vetëm 6% në sektorin publik. Në sektorin privat romët punojnë si të vetëpunësuar (64%), në bujqësi (11%) dhe si punonjës (19%). Ata punojnë në sektorin formal dhe informal të ekonomisë.

GRAFIKU 2.5. Sektorët e punësimit (Në përqindje)



Burimi: Anketa e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - Soros, 2012

## Llojet e punës në sektorin formal

### Bujqësia

Thuhet se 4% e të anketuarëve, kryesisht romë të fisit Meçkar, i sigurojnë të ardhurat e tyre nga puna në bujqësi. Të dhënat tregojnë se rreth 52% e familjeve romë që banojnë në fshat zotërojnë tokë bujqësore me një sipërfaqe mesatare prej rreth 1 hektar, të ndarë në disa ngastra të vogla dhe larg njëra-tjetrës. Ndërkaq, shumë familje romë nuk kanë përfituar tokë bujqësore<sup>13</sup> ose e kanë shitur atë në vitet e para të tranzicionit. Kryetari i një komune në rrethin e Lushnjës thotë: “Në Grabian të gjitha familjet romë janë trajtuar me tokë në bazë të frymëve, por në kushtet që është sot bujqësia harroje se mund të të dalë. (...) Një pjesë e komunitetit rom, besoj te 50% (...) e kanë shitur tokën bujqësore ose një pjesë të saj për nevoja të momentit. Kanë qenë ngushtë ekonomikisht dhe e kanë shitur”. Ndërkaq, rreth 19% e familjeve që zotërojnë tokë bujqësore e lënë djerrë dhe 20.2%

13. Sipas intervistave, familjet në Fushë-Krujë, të ardhura nga fshati Halil, si dhe ato të fisit bamill në Levan, nuk kanë përfituar tokë bujqësore.



e kanë dhënë me qira<sup>14</sup>. Të tjerët e mbjellin atë me drithra dhe perime, kryesisht për konsum familjar.

Fatmiri, një rom nga fshati Vloçisht i Korçës, tregon: “Tokë kemi 5-6 dynmë. E përdorim për vete, se për treg nuk kemi. Janë mundësitë e pakta. Thjesht për nevojat personale”.

Rrjedhimisht ekonomia bujqësore e shumë familjeve rome - si pasojë e mungesës së infrastrukturës, çmimit të lartë të inputeve dhe konkurrencës së produkteve bujqësore të importuara – nuk prodhon për treg, por për të plotësuar një pjesë të nevojave të familjes. Hilmiu, një rom që punon në bujqësi, ankohet: “Unë e kam mbjellë tokën (...), por jemi pa vaditje. Uji për ne është jeta, po s’patëm ujë me çfarë do ta vadisim prodhimin tonë? Çmimi i naftës është shumë i lartë (...) Bujqësia ka shumë punë që bëhen me naftë. Na ka ardhur në majë të hundës ...”.

### Shitja e veshjeve të përdorura

Sipas të dhënave të anketës, thuhet se 23% e familjeve rome - kryesisht të fisit Karbuxh dhe Cergar, që nga tradita janë tregtarë të vegjël<sup>15</sup> - kanë si burim kryesor jetese të ardhurat nga shitja e rrobave të përdorura. Ata i blejnë rrobat e përdorura nga tregtarët me shumicë dhe i shesin në tregjet me pakicë të qyteteve ose i tregtojnë nëpër fshatra. Disa familje rome i marrin rrobat e përdorura nga të afërmit e tyre në Greqi. Në disa qytete të vendit (Elbasan, Korçë, Pogradec etj.) tregjet me pakicë të rrobave të përdorura zotërohen nga romët. Disa familje të tjera rome merren edhe me shitjen e rrobave të reja (5%) ose me shitjen e metrazheve (2%). Rrobat e përdorura tregtohen nga romët edhe në tregun informal.

Duke filluar nga viti 1991 kjo tregti ka qenë burimi kryesor i të ardhurave familjare. Ndërkaq, që në vitin 2005, disa studiues paralajmëronin se “këto të ardhura janë në rënie” dhe nëse “nuk zhvillohen alternativa të qendrueshme, mirëqenia e tyre ekonomike do të jetë e rrezikuar”<sup>16</sup>. Viteve të fundit, burimet e të ardhurave të shumë familjeve rome nga tregtia e rrobave të përdorura janë zvogëluar ose kanë shteruar si pasojë e rënies së kërkesës, varfërisë dhe rritjes së konkurrencës.

Skënderi, një tregtar nga Durrësi, shpjegon shkaqet e kësaj gjendjeje: “Ne romët tradicionalisht jemi marrë me tregti, si ajo e rrobave të përdorura, rrobave të reja, këpucëve, metrazheve etj. Por ka disa vjet që tregtia është në rënie të vazhdueshme,

14. UNDP., *Needs Assessment Study on Roma and Egyptians Communities in Albania*, 2012

15. Sipas anketës 76.5% e tregtisë së rrobave të përdorura realizohet nga romët e fisit Karbuxh (64.7%) dhe Cergar (11.8%)

16. De Soto H., Beddies S., Gedeshi I., *and Egyptians in Albania: From social exclusion to social inclusion*. The World Bank. Washington D.C.. 2005.

sepse fuqia blerëse është ulur. (...) Ka zona, si në Elbasan, Fushë-Krujë etj., ku tregtia e rrobave të përdorura ka rënë fare dhe romët po e braktisin për t'u marrë me mbledhjen e kanaqeve. (...) Gjendja ka shkuar në fund, është përkeqësuar”.

Ndërsa Pranvera nga Fushë-Kruja tregon për komunitetin e saj: “Që kur filloi tranzicioni, të gjithë ne filluam të merremi me tregtinë e rrobave të përdorura, çka ishte burimi kryesor i të ardhurave në komunitetin tonë. Unë dilja në treg bashkë me dy djemtë e mi. (...) Ndërsa tani vetëm dy familje nga komuniteti merren me tregtinë e rrobave të përdorura, ndërsa unë kam muaj që nuk kam dalë në treg. (...)”

Ndërkaq, një krahasim i të dhënave të anketës me studimin e De Soto *et al*<sup>17</sup>, tregon se vitet e fundit ka ndodhur një zhvendosje e punësimit nga tregtia e rrobave të përdorura drejt grumbullimit të hekurishteve. Krahas shkaqeve të mësipërme, një faktor tjetër që ka ndikuar në këtë zhvendosje është edhe pakësimi i burimeve nga migrimi<sup>18</sup>. Agroni, një rom nga Elbasani, tregon: “Prindërit e mi janë emigrantë në Greqi dhe rrobat e përdorura i marrim te kazani ku i hedh greku. Ata duan 6 muaj për të grumbulluar një gjysmë makine me rroba dhe pastaj i sjellin këndeje për t'i shitur ne. (...) Por tani, meqë ra kjo krizë, grekët ua japin rrobat e përdorura njerëzve të tyre ose i shpien në kishë. (...) Kështu që të ardhurat ranë si për prindërit që i grumbullojnë në Greqi, ashtu edhe për ne që i shesim në Shqipëri”.

## Llojet e punës në sektorin informal

Si pasojë e varfërisë dhe e përjashtimit social nga tregu formal i punës romët i drejtohen tregut informal, kryesisht në mbledhjen e hekurishteve, punët e rastit, muzikë, punime të thuprës dhe metalit, lypje etj. Të ardhurat nga sektori informal përfaqësojnë sipas anketës rreth 61% të të ardhurave totale të familjes rome. Këto forma të punësimit sigurojnë të ardhura të ulta për familjet e tyre dhe prekin sigurinë e tyre ekonomike në perspektivë.

---

17. De Soto H., Beddies S., Gedeshi I., and Egyptians in Albania: From social exclusion to social inclusion, The World Bank, Washington D.C., 2005.

18. Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë., Migrimi i romëve. Si mund të maksimizojmë përfitimet e tij? Tiranë, 2012.

## Mbledhja e hekurishteve

Sipas anketës mbledhja dhe shitja e hekurishteve dhe kanaçeve është sot burimi kryesor i të ardhurave për 35% të familjeve rome, kryesisht të fisit Karbuxh dhe Cergar. Burra, gra dhe fëmijë romë mbledhin hekurishte në kolektorët urbanë të mbetjeve. Shumë prej tyre shkojnë gjatë ditës në qytetet ose fshatrat pranë për të gërmuar në kazanet e mbetjeve ose në pikat e hedhjes së mbeturinave. Disa të tjerë i blejnë me një çmim më të ulët në familjet qytetare/fshatare dhe i shesin me një çmim më të lartë në pikat e grumbullimit. Ademi, një lider informal, i ndan mbledhësit e hekurishteve dhe kanaçeve në dy grupe: ata që kanë motoçikleta dhe ata që kërkojnë në kazanët e mbetjeve. Të parët kanë të ardhura më të larta, ndërsa të dytët thjesht mbijetojnë. Ky aktivitet është zgjeruar sot me grumbullimin e plastikës, kartonave dhe qelqit.

Ndërkaq, rritja e numrit të romëve që përfshihen në grumbullimin e hekurishteve dhe të kanaçeve rrit konkurrencën dhe, në kushtet e burimeve të kufizuara, zvogëlon të ardhurat e familjeve. Në këto kushte, shumë romë zgjedhin migrimin në qytete të tjera, ku konkurrenca është më e vogël. Gjatë viteve të fundit, si pasojë e këtij procesi, romët i gjejmë në Shkodër, Beltojë, Ura e Drojës, Kukës, Peshkopi, Shupenzë, Milot, Ura e Dajlanit, Farkë dhe Shkozë të Tiranës, Vrion të Sarandës etj<sup>19</sup>. Arbeni, një rom nga Tirana, që ka migruar në Peshkopi, shpjegon: “Këtu ka më tepër punë dhe nuk ka shumë konkurrencë si në Tiranë ...”.

Por ka edhe arsye të tjera pse romët migrojnë. Avniu nga Elbasani, që jeton prej disa vitesh në Shkodër, thotë: “Unë jam nga Elbasani dhe çdo ditë mbledh kanaçe, hekura dhe bateri. Ndërsa gruaja lyp në qytet. Në Elbasan nuk ke çfarë të mbledhësh, kurse këtu ka punë. Në Elbasan më vinte zor të punoja me hekura dhe rrija në shtëpi. Kurse këtu nuk më njeheri dhe dal për të punuar”.

### Grumbullimi i hekurishteve - burimi kryesor ekonomik i një numri

---

19. Në shumë nga vendbanimet e reja, romët jetojnë në kampingje që përbëhen nga çadra ose kasolle të vendosura kryesisht buzë lumenjve. Të gjithë jetojnë kryesisht me të ardhurat nga grumbullimi dhe shitja e sendeve metalike, ndërsa gratë dhe fëmijët e vegjël lypin. Migrimi i brendshëm, nga njëra anë, i ndihmon romët të mbijetojnë në afat të shkurtër. Ndërsa, nga ana tjetër, ai ka pasojë negative për familjet dhe sidomos për fëmijët. Ai prek shkollimin e tyre, shëndetin dhe sigurinë ekonomike.

gjithnjë e më të madh familjesh rome - shumë shpejt mund të arrijë limitet e veta. Nga njëra anë ai varet nga fluktacioni i çmimit të metaleve në tregun ndërkombëtar (një ulje e çmimit mund të çojë në varfëri ekstreme shumë familje). Ndërsa nga ana tjetër rezervat e skrapit në Shqipëri janë të shterrueshme<sup>20</sup>. Kjo periudhë mund të zgjatet vetëm në qoftë se produkte të tjera (letra, plastmasi, qelqi etj.) përfshihen në riciklim. Në kushte të caktuara, një rrezik tjetër mund të përbëjë edhe miratimi i ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, i cili duke rregulluar të gjithë zinxhirin e procesit të riciklimit mund të nxjerrë jashtë këtij sektori shumë grumbullues informale romë<sup>21</sup>.

Ndërkaq, ky proces shoqërohet me një dekulifikim të plotë të fuqisë puntore (i cili do të demotivojë edhe arsimimin), humbje të elementeve të dinjitetit njerëzor dhe sjell një izolim e segregim të komunitetit. Një grua rome nga Rrapishta e Elbasanit, që punon në Farkë, thotë: “Kur arrin njeriu të kontrollojë kazanët, ky është fundi (...). Tregtia e rrobave të përdorura nuk ecën. Kaq ishte. Ndaj dhe ne hoqëm dorë dhe vendosëm të punojmë me kanaçet. Kur shkoj nëpër kazanë e mbuloj fytyrën se më vjen turp. Kjo është jeta e fundit për ne. (...)”.

### **Puna e rastit**

Në qytete dhe fshatra punëkërkuarët romë mblidhen në sheshe të caktuara, shpesh të quajtura ‘Omonia’<sup>22</sup>, ku presin punëmarrësit. Zakonisht ata pajtohen për punë ditore të pakualifikuara në ndërtim, bujqësi, ngarkim-shkarkim etj. Paga ditore e një punëtori varet nga kërkesa dhe oferta dhe varion nga 1000 deri në 2000 lekë. Në fshatrat e Korçës, për shembull, shumë romë punojnë me ditë si argatë në ekonomitë e tjera bujqësore. Të tjerë punojnë si punëtorë të pakualifikuar në ndërtim, në

---

20. Disa lajme sporadike në shtypin periodik tregojnë se elementë të infrastrukturës (pusetat e rrugëve, shinat, tubacionet e gazit, kabllot elektrikë) deri monumentet historike grabiten për skrap, çka flet se ky proces gradualisht po i afrohet fundit.

21. Në korrik-gusht 2012 Bashkia e Tiranës nxorri një urdhër për të ndaluar shfrytëzimin e kolektorëve të mbetjeve urbane nga punëtorë informale për të siguruar mbetje të riciklueshme si dhe ndalimin e transportimit të tyre brenda qytetit. Kjo përbën një shembull të rrezikut që kërcënon në të ardhmen këtë burim jetese për qindra familje rome.

22. Emri “Omonia” i referohet një sheshi në Athinë, ku shumë migrantë shqiptarë mblidhen për të kërkuar punë.

qytet ose në fshat. Puna e rastit nuk është e garantuar. Ajo rrit pasigurinë ekonomike dhe stresin psikologjik.

## Muzika

Një formë tjetër e punës informale është edhe muzika. Grupe të organizuara muzikantësh romë nga qytete dhe fshatra marrin pjesë në dasma dhe ceremoni të ndryshme festive. Kjo kërkesë është më e lartë gjatë periudhës së verës dhe vjeshtës kur organizohen zakonisht dasmat. Skënderi, një rom nga fshati Xhafzotaj, tregon: “Muzika është burimi kryesor i të ardhurave në familjet tona. Shkojmë nëpër lokale, punojmë në orkestra nëpër lokale, ku më ndonjë dasmë”.

Por këto të ardhura janë të pamjaftueshme dhe në rënje. Hasani, lideri rom nga Azotiku, shpjegon: “Një pjesë e familjeve sigurojnë të ardhura nga muzika. Por dhe kjo punë sa vjen e po mbaron. Kanë DJ tani ... Në mbrëmje burrat venë nëpër dasma dhe në mëngjes dalin e tregtojnë rroba dhe këpucë të përdorura. Ose burri vete në dasmë, ndërsa gruaja shet në treg”.

## Punimet e thuprës dhe të metalit

Një formë tjetër e punës informale është edhe prodhimi i artikujve prej kashte dhe metali. Disa familje rome e ruajnë dhe trashëgojnë këtë traditë. Në Shkozë të Durrësit disa familje rome të ardhura kryesisht nga Rrapishta e Elbasanit dhe Bilishti thurin çadra prej kashte për pushuesit në bregdet gjatë periudhës maj-gusht. Hasani, një rom nga Elbasani, thotë: “Ne punojmë çadra për plazh. Ne vijmë këtu nga qershori dhe rrimë deri në fund të gushtit, pastaj kthehem në Elbasan. Ne punojmë edhe burrat, edhe gratë. Gratë korrin kashtën dhe ne burrat bëjmë çadrat. Dita e punës shkon 15-20 mijë lekë<sup>23</sup>. (...) Të ardhurat i përdorim dhe gjatë dimrit sa të hamë një capë bukë”. Në Gjirokastër, disa familje rome nga Zinxhiraj thurin kanistra të madhësive të ndryshme prej kashte dhe i shesin në qytet ose në fshatrat përreth. Në fshatin Sovjan të Korçës disa familje rome bëjnë fshesa gjatë dimrit. Në Delvinë, Levan dhe në vendbanimin e Azotikut familje të tjera rome prodhojnë në forma artizanale dhe shesin kazanë për prodhimin e rakisë. Disa familje në Delvinë mbledhin dhe

---

23. Në të gjitha intervistat, romët flasin me lekë të vjetra. Për t'i konvertuar me lekët e sotëm, ata duhen pjestuar me 10.

shesin bimë medicinale.

### Lypja dhe forma të tjera

Një formë e veçantë e punës informale është lypja e parave kryesisht në qytetet e mëdha. Familje romë nga vendbanimi i Azotikut në Fier migrojnë gjatë sezonit të verës në qytetin e Durrësit dhe lypin në port pranë pikave të ndalimit të trageteve të udhëtarëve. Gra dhe fëmijë nga Cërriku, Elbasani dhe Fushë-Kruja lypin gjatë sezonit të verës në plazhin e Durrësit. Shpresa, një romë nga Fushë-Kruja, shprehet: “Kemi ardhur se nuk kemi as përkrahje sociale atje dhe vijmë këtu të lypim dhe të hamë një copë bukë. Unë po bëj tre muaj që kam ardhur këtu (...). Unë lyp, kurse burri i bie gajdes. Është 70 vjeç, por i sjell 3 mijë lekë dhe hamë bukë”.

Gra dhe fëmijë romë deri në 12 vjeç, nga fshatrat ose vendbanime të varfëra, shkojnë për të lypur në qytet. Astriti, një djalë 9 - vjeçar rom nga Kthesa e Ariut, tregon: “Ne lypim nëpër fshatra sa të hamë një copë bukë. Në Durrës, në pazar shkojmë. Shkoj për ditë, vetëm shkoj. Fitoj dhe 3 mijë lekë, unë jetoj me mamën ...”

### Konkluzione dhe rekomandime

Gjatë tranzicionit passocialist romët kaluan nga punësimi i plotë dhe i garantuar në papunësi masive dhe afatgjatë. Si pasojë e varfërisë dhe përjashtimit social ata u spostuan gradualisht nga tregu formal në tregun informal, ku bëjnë punë të pakualifikuara, me të ardhura të ulta, që prekin sigurinë e tyre ekonomike në afat të mesëm dhe të gjatë. Në rast se këto prirje thellohen, romët do të vazhdojnë të jenë edhe në të ardhmen të mbërthyer në kurthin e varfërisë.

Të dhënat e anketës tregojnë se arsimit dhe kualifikimi i romëve - të cilat janë përkeqësuar gjatë tranzicionit passocialist - nuk janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ato janë dy nga hallkat kryesore që duhen përmirësuar për punësimin e romëve dhe nxjerrjen e tyre nga cikli i varfërisë. Krahas arsimimit, politikat duhet të përqëndrohen në kualifikimin e romëve nëpërmjet trainimeve për profesione që realisht kërkohen në tregun formal të punës dhe ku mundësitë e punësimit ekzistojnë. Në këtë rast qendrat e trajnimit profesional duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me zyrat e punës, pushtetin vendor, dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit etj. Ky bashkëpunim është i ndërsjellë. Nga

njëra anë, zyrat e punës dhe shoqatat e biznesit mund t'u transmetojnë qendrave të formimit profesional kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, të cilat janë dinamike dhe të ndryshme sipas rretheve. Nga ana tjetër, këto të fundit duhet të ndikojnë për punësimin e tyre. Njësitë e qeverisjes vendore mund të ndikojë në punësimin e romëve nëpërmjet uljes së taksave për bizneset që i punësojnë ose duke marrë përsipër pagesën e sigurimeve shoqërore. Rrjedhimisht, treguesi i suksesit të këtij bashkëpunimi nuk është numri i romëve të trajnuar, por numri i romëve të punësuar sipas profesionit në sektorin formal.

Një shembull interesant i një biznesi social - me pjesëmarrjen e romëve, bashkisë/komunës dhe një institucioni bankar - do të ishte grumbullimi dhe shitja e hekurishteve<sup>24</sup>. Ky biznes social do të harmonizonte interesat e partnerëve. Interesi i pjesëtarëve/familjeve të komunitetit rom do të ishte punësimi dhe kushtet më të mira të punës, rritja e të ardhurave, formalizimi i biznesit dhe përfshirja më e madhe në shërbimet dhe sigurimet sociale. Rritja e të ardhurave do të rezultonte nga shitja direkte e produkteve të grumbulluara të sipërmarrësit kryesorë, duke shmangur ndërmjetësitë sekondarë që marrin një pjesë të madhe të fitimit.

Interesi i pushtetit lokal do të ishte punësimi i romëve dhe zvogëlimi i "ndihmës ekonomike" për këtë komunitet - në një fazë të dytë - si rezultat i rritjes së punësimit. Punësimi në biznese sociale mund të kushtëzohet edhe me dërgimin e fëmijëve në kopshte e shkolla. Veç kësaj, pushteti lokal do të organizonte një riciklim më të mirë të mbetjeve urbane. Për këtë biznes social mund të ofrohet një magazinë për grumbullimin e hekurishteve dhe automjete për transportimin e tyre.

Institucioni bankar do të shërbente për vendosjen e disiplinës financiare në drejtimin e këtij biznesi dhe do të ruante, për çdo pjesëtar/familje të komunitetit rom, një përqindje të të ardhurave. Këto të ardhura mund të shërbejnë edhe për pagimin e kësteve për banesat sociale. Në rast se kjo nismë do të rezultojë e suksesshme, ky lloj biznesi social mund të shtrihet edhe në sektorë të tjerë dhe në zona të tjera të vendit.

Të dhënat sasiore dhe cilësore tregojnë se mungesa e punësimit në sektorin formal i shtyn detyrimisht romët në sektorin informal. Qeveria,

---

24. UNDP., *Needs Assessment Study on Roma and Egyptians Communities in Albania*, 2012

sektori privat, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile duhet të bashkëpunojnë midis tyre për formalizimin e këtij tregu. Ky formalizim është një proces gradual, i cili kërkon domosdoshmërisht edhe pjesëmarrjen aktive të romëve. Ai duhet paraprirë nga një ndërgjegjësime i komunitetit rom lidhur me përfitimet afatgjata të tij (kundrejt atyre afatshkurtëra). Ndërkaq, ai duhet lehtësuar - nëpërmjet kredive të buta, donacioneve të organizatave ndërkombëtare, organizimit të tregjeve, etj. - në mënyrë që kostoja e këtij tranzicioni të jetë e përballueshme për familjet e varfra rome.


Një zgjidhje për formalizimin e këtij tregu, punësimin dhe rritjen e të ardhurave për komunitetin rom mund të ishte edhe krijimi i bizneseve sociale, si për shembull në grumbullimin e shitjen e hekurishteve, në riciklimin e plastmasit, letrës dhe qelqit, në punimet e kashtës, në prodhimin bujqësor, në mbledhjen e shitjen e bimëve medicinale etj. Këto biznese mund të kishin si partnerë, krahas pjesëtarëve të komunitetit rom, edhe bashkinë/komunën, sipërmarrës privatë dhe një institucion bankar. Një fondacion mund të kryejë fillimisht studimin e biznesit social dhe të drejtojë projektin.





# 03   **Arsimi, Shëndeti dhe Strehimi**

Paçka financimeve të shumta nga donatorë ndërkombëtare, përfshirjes së Shqipërisë në Dekadën Rome si dhe zbatimit të nismave nxitëse të tilla si ofrimi i teksteve shkollore pa pagesë për arsimin e detyrueshëm, pjesmarrja e komunitetit rom në arsim, si dhe shkalla e përfitimit nga ky shërbim mbetet në nivele mjaft më të ulta krahasuar me pjesën tjetër të popullatës




## Arsimi



Arsimi përbën një nga sfidat më të rëndësishme, por edhe një aspekt kyç në mbështetje të përpjekeve për përfshirjen, si dhe rritjen e mirëqenies së komunitetit rom. Arsimi shfaqet si faktor i rëndësishëm si në aspektin ekonomik, ashtu edhe sa i përket rritjes së peshës së komunitetit rom në vendimarrjen publike të vendit. Megjithë financimet e shumta nga organizatat ndërkombëtare, përmirësimi të legjislacionit si dhe zbatimit të nismave nxitëse të tilla si ofrimi i teksteve shkollore pa pagesë për arsimin e detyrueshëm, pjesmarrja e komunitetit rom në arsim, si dhe shkalla e përfitimit nga ky shërbim mbetet në nivele mjaft më të ulta krahasuar me pjesën tjetër të popullatës.

Aksesi fizik në këtë shërbim përbën një nga kushtet elementare për marrjen e tij. Anketa në shkallë vendi e realizuar gjatë muajit nëntor 2012 dëshmon se pavarësisht se shërbimi arsimor paraqitet i arritshëm fizikisht nga komuniteti rom, përdorimi i këtij shërbimi nuk është gjithmonë i mundshëm. Sipas vetëdeklarimeve të prindërve romë, mundësia për arsim ofrohet në zonat e tyre të banimit në 85% të rasteve. Në rreth 12% të rasteve të anketuarit deklarojnë se në zonën ku ata banojnë nuk ekzistojnë mundësitë për arsimim të fëmijëve të tyre.

GRAFIKU 3.1. A ekziston në vendin ku banoni ju arsimimi i fëmijëve? (Në përqindje)



Më tej anketa tregon se rreth 40% e popullatës rome 10 vjeç e lart, si dhe 36% e fëmijëve të grupmoshës 7 deri në 15 vjeç nuk kanë kryer asnjë klasë shkollë, shifër kjo mjaft e lartë krahasuar me nivelin e analfabetizimit në shkallë vendi për të gjithë popullsinë shqiptare: rreth 3% për grupmoshën 10 vjeç e lart dhe 1% sa i perket grupmoshës 7 deri në 15 vjeç<sup>25</sup>.



25. Albanian Census2011 [http://www.instat.gov.al/media/177354/main\\_results\\_\\_population\\_and\\_housing\\_census\\_2011.pdf](http://www.instat.gov.al/media/177354/main_results__population_and_housing_census_2011.pdf)

Po kështu edhe piramida e arsimimit të komunitetit rom krahasuar me atë të popullatës së përgjithshme, sipas rezultateve të Censurit 2011, paraqitet e ndryshme. Anketa tregon se rreth 33% e romëve të moshës 10 vjeç e sipër ka përfunduar 4 klasë shkollë krahasuar kjo me vetëm 15% të së njëjtës gruposhë në popullatën e përgjithshme. Më tej, rreth 21% e romëve të pyetur deklaroi të ketë përfunduar arsimin e detyrueshëm, shifër e ulët krahasuar me 41% të popullatës së përgjithshme, që pozicionohet në të njëjtin nivel arsimor. Situata paraqitet edhe më e pangjashme në rast se do t'u referoheshim deklaramenteve për përfundimin e arsimit të mesëm, pasi vetëm rreth 3% e komunitetit rom deklarohet ta ketë përfunduar atë krahasuar me 28% të personave pjesë e popullatës së përgjithshme, që rezultojnë ta kenë përmbyllur arsimin e mesëm.


Një përqindje kaq e lartë e popullatës pa arsim shtuar edhe rezultatin e anketës i cili tregon se rreth 81% e romëve në moshë pune të pyetur nuk zotëronin asnjë profesion apo zanat dëmton shanset për përfshirjen në tregun formal të punës, si dhe aftësinë për t'iu përshtatur një ekonomie në ndryshim. Arsimimi i pamjaftueshëm për një pjesë të madhe të komunitetit rom sugjeron një perspektivë të zymtë për të ardhmen, sfidë e cila do të shfaqet edhe më e prekshme për shoqërinë tonë në një fazë të mëtejshme zhvillimi, kur formalizimi i ekonomisë, shtrirja e politikave sociale dhe plakja e popullsisë do të kenë arritur nivele të larta. Shkalla e ulët e arsimit të pjestarëve të komunitetit rom dëmton, gjithashtu, mundësinë për t'u orientuar shpejt në përmbylljen e kërkesave për të përfituar nga shërbimet publike bazë, si dhe shton gjasat për t'u përballur me pengesa që shfaqen si pasojë e burokracisë joefektive, e cila karakterizon një pjesë të institucioneve publike<sup>26</sup>.

Në vazhdim anketa tregon se rreth 70% e familjeve të përfshira në studim pranojnë të kenë fëmijë në moshë kopshti apo shkolle. Të pyetura më tej 30% e familjeve që deklarojnë se kanë qoftë dhe një fëmijë në moshë kopshti apo shkolle, shprehen se fëmijët e tyre nuk frekuentojnë anjërin prej këtyre institucioneve arsimore.

---


26. *Albania Progress Report 2012*, fq. 9, 10, 11: [http://ec.europa.eu/enlargement/countries/strategy-and-progress-report/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/countries/strategy-and-progress-report/index_en.htm)

**GRAFIKU 3.4. A keni fëmijë në moshë shkolle? (Në përqindje)**



Kjo shifër mbështetet edhe nga rezultatet e siguruarat përmes pyetjes lidhur me aftësinë e familjes për të përballuar koston e arsimit të fëmijës. Të pyetur rreth kësaj çështjeje, 31% e familjeve romë deklarojnë se kostoja e arsimit të fëmijës së tyre është e papërbalueshme për ta.

**GRAFIKU 3.5. Sa e vështirë është për familjen tuaj të përballojë arsimin e fëmijës në shkollën fillore? (Në përqindje)**



Një studim cilësor i kryer gjatë viti 2009<sup>27</sup> dëshmon se një pjesë e prindërve të komunitetit rom e përshkruajnë gjendjen e tyre ekonomike si shumë të vështirë. Shumica e tyre shesin në tregje të hapura, mbledhin hekurishte dhe punojnë në mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve. Disa prej tyre shprehen si më poshtë:

*“Me të ardhurat e mia dhe gjendjen time, që është shumë e paqëndrueshme, fëmija im nuk mund të krahasohet me fëmijët e tjerë. Ne sakrifikojmë shumë që fëmijët tanë të jenë si të tjerët”.*

**PRIND ROM 37- VJEÇAR, I NJË FËMIJE TE ARSIMIT 9-VJEÇAR**

*“Nuk është e lehtë të mbash një fëmijë në shkollë. Ky është një problem i madh. Unë kam një vajzë që shkon në shkollë. Unë jam i papunë dhe përpos vajzës kam edhe dy fëmijë të tjerë. Unë nuk ia dal dot t'i blej asaj gjithçka i nevojitet”.*

**PRIND ROM 41- VJEÇAR, I NJË FËMIJE NË SHKOLLËN FILLORE**

*“Ne e kemi thënë edhe gjatë takimeve, se nuk mund të kontribuojmë në organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Ne mezi sigurojmë të ardhura për familjen dhe s'behet fjalë të përballojmë shpenzimet e ekskursioneve. Unë nuk dua që fëmija im të ngelet prapa fëmijëve të tjerë. Që këtu fillon diskriminimi, kur njerëzit fillojnë të dallojnë ata që mund të përballojë diçka dhe ata që nuk mundin. “*

**PRIND ROM 37-VJEÇAR, I TRE FËMIJËVE QË NDJEKIN SHKOLLËN**


Arsyet për një përqindje kaq të lartë të braktisjes apo të mosregjistrimit në shkollë mund të gjenden në situatën e vështirë ekonomike, kushtet e vështira të jetesës, nivelin e ulët arsimor të një pjesë të madhe të prindërve romë, por edhe në shkallën e lartë të skpticizmit ndaj rolit të arsimit në suksesin ekonomik dhe profesional apo edhe pengesave shkurajuese që gjenden brenda vetë sektorit të arsimit. Më tej, duke iu referuar një prej masave të planit të veprimit të dekadës romë në fushën e arsimit, anëtarë të komunitetit rom u pyetën lidhur me ekzistencën e programeve të këshillimit për prindërit romë pranë shkollave ku mësojnë fëmijët e tyre. Rezultatet e anketës tregojnë se rreth 43% e prindërve deklarojnë se nuk kanë asnjë informacion lidhur me këto programe.

---

27. Raporti i studimit “Avancimi i Pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të komunitetit Rom në arsim”, Triane: Nentor 2009, OSFA dhe CDE, <http://apreme.net/news.html>



**GRAFIKU 3.6. A keni dëgjuar për programe këshillimi në shkollat/kopshtet e fëmijve tuaj për prindërit Rome, në lidhje me mbështetjen arsimore të fëmijës suaj? (Në përqindje)**



Sipas një studimi të kryer në vitin 2009 me fokus pjesëmarrjen e prindërve në arsim, “prindërit romë shprehen se nuk ndihen të sigurt nëse shkolla do të mirëpriste përfshirjen e tyre në veprimtaritë e institucionit<sup>28</sup>. Ata janë ngurrues pasi besojnë se ekzistojnë mësues të cilët nuk do të dëshironin të punonin me “njerëz si ata”. Shumica e prindërve mendojnë se familjet rome dhe ato të varfra janë të përjashtuara nga veprimtaria shkollore. Për më tepër, prindërit e shumicës së popullsisë pranojnë se kanë paragjykime ndaj romëve”.

Klima e përgjithshme e shkollës është mjaft e rëndësishme sidomos nëse marrim në konsideratë rrethanat e pjesës më të varfër dhe vulnerabël të komunitetit rom, e cila mund të shkurajohet lehtësisht. Sipas studimit mbi pjesëmarrjen e grupeve të pakicave etnike në arsim të realizuar në vitin 2009<sup>29</sup> një pjesë e prindërve romë shprehen se fëmijët e tyre dhe ata egjiptianë trajtohen keq dhe se në shkollën ku mëson fëmija është e ndaluar që një klasë të ketë një numër të madh prej tyre, pasi “mendohet se ata shkaktojnë probleme nëse ndodhen bashkë në të njëjtën klasë”.

28. Center for Democratic Studies (CDE). Focus Group Report. National Survey of Parents in SEE Countries. Parents’ participation. May – June 2009. p.4 <http://www.seeducoop.net/aeiq/documents/parents/fg/albania-fg.pdf>

29. Raporti i studimit “Avancimi i Pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të komunitetit Rom në arsim”, Triane, Nentor 2009, OSFA dhe CDE, <http://apreme.net/news.html>

Gjatë intervistave dy prej prindërve u shprehën kështu:

*“Ka shumë diskriminim. Për të mos përmendur faktin se nuk mund të mendohet që një fëmijë i komunitetit tonë mund të bëhet dikushi. Ka pasur raste që fëmija ka studiuar, por nuk ka marrë vlerësimin e merituar.”*

PRIND ROM 40-VJEÇAR, I DY FËMIJËVE NË SHKOLLË


*“Njëherë ndodhi që vajza ime u dënua nga mësuesi i saj me notë mbetese sepse mësuesi nuk i besoi asaj. Ajo i kishte bërë detyrat e shtëpisë, por një nxënës tjetër bëri detyrat e veta duke kopjuar prej saj. Mësuesi nuk i besoi vajzës sime, por i besoi nxënësit tjetër, që ishte i bardhë”.*

PRIND ROM 37-VJEÇAR, I NJË FËMIJE NË SHKOLLË 9-VJEÇARE

Megjithatë, sipas këtij studimi, në përgjithësi, prindërit romë konfirmojnë se komunikimi midis tyre dhe mësuesve është përmirësuar me kalimin e kohës. Diskriminimi është më i pakët krahasuar me të shkuarën.

Kontakti me mësuesin përbën një faktor të rëndësishëm në rritjen e besimit të prindërve romë ndaj institucioneve arsimore, si dhe inkurajimin e mbështetjes së tyre ndaj arsimimit të fëmijëve. Të pyetur rreth shpeshësisë së takimeve me mësuesit e fëmijëve të tyre, 46% e prindërve pjesmarrës në anketë shprehen se nuk e kanë takuar asnjëherë mësuesin e fëmijës së tyre përgjatë vitit 2012.

**GRAFIKU 3.7. Gjatë vitit të kaluar sa herë jeni takuar me mesuesen/mësuesit e fëmijës suaj për çështje që kanë të bëjnë me arsimimin e fëmijës suaj? (Në përqindje)**



Regjistrimi në shkollë i fëmijëve që mund të kenë braktisur shkollën apo që zhvendosen me banim përgjatë vitit shkollor është një çështje e cila u vëzhgua përmes metodës së “mystery shopping”<sup>30</sup>. Disa prindër nga komuniteti rom dhe jo rom u paraqiten në shkolla të caktuara për të regjistruar fëmijët e tyre. Rastet paraqiten si më poshtë:

## Rasti i regjistrimit në shkollë

Dy gra, Mimoza dhe Sonila, e para rome dhe tjetra nga popullsia në shumicë, shkuan në disa shkolla të kryeqytetit për të regjistruar fëmijët e tyre, të cilët kishin 1-2 vjet që kishin braktisur shkollën. Mimoza tregon: “Shkova në katër shkolla për të regjistruar vajzën, por në asnjërën prej tyre nuk ma pranuan. Drejtuesit e shkollave, me përjashtim të një rasti, më pritën shumë mirë në zyrat e tyre. Ata më thanë se vajza vetëm një vit ka humbur dhe mund të futet në një klasë normale. Por të gjithë u shmangën kur erdhi puna për regjistrimin dhe asnjëra nuk më adresoi për te drejtoria arsimore”. Mimoza tregon se në shkollën e parë drejtuesi i tha se “do kisha shumë dëshirë ta merrja vajzën (...), por ti e shikon vetë se sa të mbushura i kam klasat dhe imagjino sikur të sjell edhe një bankë tjetër”. Në shkollën e dytë i thanë se “po të kishim vend do ta fusnim, se një vit nuk është shumë dhe mund të futet me fëmijët e tjerë. Por shkolla ime ka shumë nxënës dhe nuk e marr dot”.

Në të tretën i thanë: “shkolla ime është shumë e zënë, por shko te shkolla tjetër”. Ndërsa në shkollën e fundit i thanë: “Tani për tani nuk bëhet fjalë, por ndoshta në semestrin e dytë. Na lër numrin e telefonit dhe në qoftë se lirohet ndonjë vend, do t’ju marrim në telefon”.

Ndërsa Sonila, pjesëtare e shumicës së popullsisë, djali i së cilës kishte dy vjet që kishte braktisur shkollën, tregon: “Edhe unë pata rezistencë, por në njërin nga këto shkolla drejtoresha më tha se “je njëçikë me vonesë dhe jo një çikë, por shumë me vonesë. Por pavarësisht do të bëjmë të pamundurën”. Ajo më kërkoi të sillja fillimisht dëftesën e klasës që ka bërë djali dhe pastaj një vërtetim nga lagjja ku banoj”.

---

30. *Mystery shopping është një teknikë që përdoret gjerësisht nga bizneset për të provuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve. Kjo teknikë konsiston në përgatitjen e disa personave, të cilët, bazuar në një skenar të mirëpërcaktuar, vizitojnë institucione të ndryshme për të marrë shërbimin përkatës. Vizita në institucione ofron mundësinë e mbledhjes së të dhënave mbi lehtësinë e aksesit të shërbimit, procedurat e ndjekura dhe rolin e punonjësve bazuar në përvoja të drejtëpërdrejta.*

Teuta, një grua nga popullsia në shumicë, u paraqit në një nga shkollat e mësipërme për të regjistruar vajzën. Ajo tregon: “Drejtoresha më priti shumë mirë në zyrën e saj. Unë i tregova se kisha ndryshuar shtëpinë dhe nga Lapraka isha vendosur në një apartament diku afër shkollës. Prandaj doja të transferoja edhe vajzën në këtë shkollë. Drejtoresha në fillim u përgjegj se “ke ardhur me shumë vonesë dhe në mes të semestrit unë nuk mund të bëj regjistrime të reja. Pastaj edhe klasat janë të tejmbushura me nxënës”. Por unë insistova. Atëhere më tha: “mirë, sill dëftesën e vajzës, më pyeti për adresën e shtëpisë dhe më kërkoi një numër telefoni”.

Zbatimi i programit të emërtuar “shansi i dytë” përbën në parim një ndërhyrje të rëndësishme që ka të bëjë me mbështetjen e arsimit të fëmijëve romë. Shifrat e larta të pranisë së nxënësve romë dhe egjiptianë në klasat e shansit të dytë, rreth 67% e popullatës së nxënësve<sup>31</sup> të regjistruar në këtë program, tregojnë për peshën e kësaj ndërhyrjeje, por në të njëjtën kohë edhe për një farë dështimi të sistemit të arsimit për t’i mbajtur këta fëmijë në klasa të rregullta. Zbatimi i këtij programi përballlet me një mori sfidash të lidhura me financimin, planifikimin, zbatimin, por edhe konceptimin e tij. Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP) në raportin e tij të vitit 2012 tregon për një mori problemesh të tilla, si:

- Programi ka marrë në konsideratë nxënës të cilët kanë braktisur shkollën, por jo ata që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë.
- Në shumicën e rasteve, veçanërisht në Korçë e Fier, klasat e projektit iu besuan OJF-ve dhe u lanë jashtë vëmendjes së strukturave shtetërore.
- Klasat e projektit nuk u bënë objekt i punës së ish- sektorëve të inspektimit në DAR dhe të ish-Drejtorisë së Inspektimit në MASH.


Efektiviteti dhe shtrirja e këtij programi mbetet për tu vlerësuar më tej. Sidoqoftë, në rast se ky program nuk rishikohet, si dhe nuk merren masa për një zbatim të kujdesshëm të tij, mund të shfaqet rreziku që një pjesë e nxënësve romë dhe egjiptianë të shtyhen drejt këtyre klasave paçka se ata mund të përfitonin më tepër nga qëndrimi në klasat e rregullta. Një prirje e tillë zbulohet edhe nga gjetjet e intervistave të zhvilluara nga IKAP-i me

---

31. Raport Vlerësimi Inspektoriatit Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, Tiranë 2012:  
<http://ikap.edu.al/?cat=16&lang=al>


mësues dhe drejtues shkollash të cilët ishin të mendimit që në klasat e shansit të dytë, përveç nxënësve fizikisht braktisës, të përfshihen edhe nxënës të cilët nuk e frekuentojnë rregullisht shkollën. Një shtrirje e tillë në grupin e synuar mund të shfaqet e rrezikshme nëse nuk menaxhohet siç duhet, pasi klasat e shansit të dytë mund të kthehen në klasa “geto” të destinuara më së shumti për fëmijët romë dhe egjiptianë. Gjithashtu, lidhur me shkallën e efektivitetit të këtij programi lind pyetja se sa ka arritur programi i “shansit të dytë” që pas një periudhe të caktuar të ketë rikthyer në klasa të rregullta nxënës të trajtuar në klasat e kësaj skeme. Madje lind pyetja nëse programi synon rikthimin e nxënësve në klasat e rregullta. Më tej vlefshmëria/njohja e diplomës që mund të përfitojnë nxënësit e shansit të dytë është një çështje me rëndësi edhe sa i përket nivelit të motivimit të këtyre fëmijëve dhe prindërve të tyre.

Zbatimi i programeve nxitëse të cilat mbulojnë një pjesë të kostove të lidhura me arsimin është mjaft i rëndësishme në mbështetje të rritjes së frekuentimit të shkollës nga komuniteti rom. Ofrimi i teksteve shkollore pa pagesë për fëmijët e komunitetit rom, të cilët mësojnë në shkollat e arsimit të detyrueshëm, është një prej angazhimeve zyrtare të qeverisë shqiptare. Duke u nisur nga ekzistenca e këtij mekanizmi, prindërit rom, të cilët kishin të paktën një fëmijë në arsimin e detyrueshëm, u pyetën nëse kishin arritur të përfitonin pa pagesë tekstet shkollore. Sipas anketës rezulton se 17% e fëmijëve romë në shkollë vendi nuk kanë mundur të përfitojnë tekstet shkollore falas paçka se kjo e drejtë garantohet nga vendimi i këshillit të ministrave nr.107, datë 10.2.2010.



Për të përmbushur këtë detyrim është mjaft e rëndësishme që udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe asaj të Arsimit dhe Shkencës, që rregullon këtë proces, të parashikojë qartë ofrimin e teksteve falas në vend të rimbursimit të tyre. Kjo pasi mekanizimi i rimbursimit mund të shkurajojë ata prindër romë të cilët nuk kanë para për të paguar aty për aty, sikundër dhe ata që ushqejnë mosbesim ndaj procedurës së rimbursimit, e cila zakonisht merr shumë kohë për t'u përmbyllur. Gjithashtu, me rëndësi të veçantë është edhe standardizimi i procedurave dhe dokumentacionit që kërkohet nga institucionet arsimore për të vërtetuar origjinën etnike të fëmijës, gjë që do të rriste efektivitetin e mekanizmit.

Mbështetja financiare e drejtëpërdrejtë në formë bursash për nxënësit pjesë e familjeve romë më vulnerabël përfaqëson një mjet nxitës mjaft efikas për të ndjekur shkollën dhe për të përballuar kostot financiare të lidhura me të. Ligji i arsimit parauniversitar, i miratuar në qershor 2012, në nenin 28 parashikon detyrimin e buxhetit të shtetit dhe përgjegjësinë administrative të qeverisë vendore për të mbështetur fëmijët pjesë e familjeve në nevojë të cilët frekuentojnë arsimin parauniversitar<sup>32</sup>. Ky detyrim ligjor është zbërthyer edhe në planin e ri të masave të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) në kuadër të përfshirjes së komunitetit rom, ku shkruhet se “MASH, në planifikimin e bursave, do të ketë në konsideratë zonat e banuara nga komuniteti rom dhe egiptian, si dhe do të bëjë



32. Ligji i Arsimit Parauniversitar: <http://www.mash.gov.al/File/arsimi-parauniversitar/Ligj-nr-69-21-06-2012.pdf>

*rekomandimet te pushteti vendor*”, masë e parashikuar për t’u zbatuar gjatë muajit shtator 2012. Lidhur me këtë çështje rezultatet e anketës tregojnë se vetëm 2% e prindërve romë iu përgjigjën pozitivisht pyetjes nëse fëmija i tyre kishte përfituar bursë nga bashkia apo komuna, por edhe kjo përqindje kaq e vogël gjendet brenda kufijve të marzhit të gabimit të këtij studimi.

Ky rezultat është mjaft domethënës duke konsideruar se sipas anketës rreth 69% e familjeve romë deklarojnë se shpenzojnë më pak se 20,000 leke në muaj. Situata bëhet edhe më e vështirë në rast se llogarisim që po sipas anketës rreth 40% e familjeve romë kanë si burim kryesor të jetesës aktivitete informale të cilat përfshijnë tregtimin e mbetjeve të riciklueshme, muzikën dhe lypjen. Të ardhurat e pakta dhe paqëndrueshmëria e tyre si pasojë e veprimtarive ekonomike informale si dhe madhësia mesatare e familjeve (4.8 anëtarë), më e lartë se ajo e shumicës së popullsisë, e bëjnë të domosdoshme mbështetjen e programeve publike për të tejkaluar pengesat ekonomike që lidhen me frekuentimin e shkollës. Kjo situatë kërkon jo vetëm zbatimin e programit të bursave për fëmijët romë pjesë e familjeve vulnerabël dhe të varfëra, por, gjithashtu, edhe zgjerimin e tij në mbështetje të fëmijëve në rrezik braktisje apo të atyre të cilët e kanë braktisur arsimin për shkaqe ekonomike. Për të realizuar këtë angazhim serioz do të nevojitej një bashkëpunim më i mirë midis MASH, Drejtorive Rajonale të Arsimit, njësive të qeverisjes vendore dhe shoqërisë civile.

Për të ilustruar mungesën e funksionimit të këtij mekanizimi mbështetjeje për arsimin e fëmijëve romë shërben edhe rasti i disa prindërve romë dhe jo romë në gjëndje të vështirë ekonomike, të cilët duke u përfshirë në veprimtarinë e “mystery shopping”, u interesuan për një bursë për fëmijën e tyre. Rastet paraqiten si më poshtë:

### **Rasti i Bursave**

Në mënyrë që programi i bursave të sigurojë dobi maksimale nevojitet një ndërthurje e tij me skemën e ndihmës ekonomike, strehimin social, si dhe mbështetjen akademike të përfituesve dhe prindërve me qëllim aftësimin e këtyre të fundit në mbështetjen e arsimimit të fëmijëve.

Gjithashtu, një çështje e lidhur ngushtë me aksesin në një shëbim cilësor arsimor, por dhe sa ka të bëjë me mbështetjen e integritetit të komunitetit janë edhe rastet në rritje të shkollave me tipare segregimi, të cilat po shfaqen në disa prej territoreve administrative të vendit. Programe të ndryshme të lidhjes së arsimimit të fëmijëve romë me ndihma në

Teuta, një nënë nga popullsia në shumicë, tregon: “Unë shkova në shkollën e vajzës në Laprakë për të pyetur për bursat për fëmijët në nevojë. “Absolutisht më thanë, as që bëhet fjalë. S’ka ardhur asnjëherë ndonjë bursë e tillë”. Pastaj shkova në DAR. Por edhe aty, pasi më sorollatën nga një zyrë në tjetrën, më thanë se “as që bëhet fjalë për këtë.”

Të njëjtën histori tregon edhe Sonila, një nënë nga popullsia në shumicë: “Në DAR bisedova me një nga drejtueset e institucionit. Jam një familje e varfër dhe kam dëgjuar se fëmijët në nevojë marrin bursa. Kam folur edhe me drejtorin e shkollës ku është vajza dhe më tha shko në DAR, se unë nuk kam për fëmijët në nevojë. “As unë, - më tha ajo, - nuk e di që marrin bursa fëmijët në nevojë”. Dhe më tha “mirëupafshim”. Pra, me një fjalë, më tha dil jashtë, mos rri më këtu”.

Ndërsa Anila, një nënë rome, është pak e shqetësuar për sorollatjet në zyrat e DAR-it. Ajo tregon: “Unë shkova në zyrat e DAR-it për të pyetur për bursat e fëmijëve në nevojë. Por më është krijuar përshtypja se atje nuk punohet fare. Kam qenë tri ditë rrjesht atje ... Mua m’u dukën të pasjellshëm punonjësit atje. Futeshe brenda në një zyrë dhe kur të thoshte çfarë do?”, nuk ngrinte as sytë të të shikonte. Më në fund më drejtuan te një nga drejtueset, por ajo nuk gjendej. Më thanë “sot ajo nuk vjen, por hajde nga e marta, se të hënën jemi shumë të zënë. Kështu hajde nga e marta ose e mërkura”. Kështu përfundoi gjithçka, sorollatje por dhe të gjitha dyert e mbyllura”.

Leta, një nënë rome që banon pranë Universitetit Bujqësor në Kamëz, tregon: “Në drejtorinë e shkollës ku mëson vajza ime u interesova për bursat. Drejtoresha e shkollës ishte shumë e prerë dhe më tha se “ajo që ju takon juve si romë janë vetëm librat që i keni falas. Asnjë gjë tjetër nuk ju takon. Kjo nuk plotësohet për ata që marrin vetëm dhjeta, jo për ju”. (...) Për bursat unë u interesova edhe te Drejtoria Arsimore. Por një nga drejtueset e institucionit më tha “se ju takojnë vetëm librat falas”.


ushqim apo veshmbathje, si dhe prirja e disa administratorëve arsimorë për ruajtjen e shkollave me popullësi nxënësish nga maxhoranca duket se po krijojnë gradualisht shkolla me maxhorancë absolute me nxënës romë dhe egjiptianë, paçka se demografia e zonës së banimit pranë shkollës nuk sugjeron një gjë të tillë. Prirjet për getoizimin dhe segregimin e disa prej shkollave të arsimit të detyrueshëm janë mjaft të dëmshme si në prespektivën e integritetit të komunitetit rom, por edhe në atë të ofrimit të një shërbimi arsimor cilësor për të gjithë nxënësit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale duhet të zbatojnë politika inteligjente të cilat kujdesen jo vetëm për ruajtjen e drejtpeshimit natyral të demografisë etnike brenda institucioneve arsimore, por, gjithashtu, të tilla



që inkurajojnë larminë etnike të shkollave, gjë që do të kontribuonte në një klimë të shëndetshme multikulturore, si dhe do të shtonte potencialin e shkollës për të ruajtur dhe rritur cilësinë e arsimit.


## Shëndeti

Shëndeti përbën një çështje të rëndësishme për çdo shoqëri ndërkohë që ai përballlet me kërcënime të shtuara në shoqëri pak të zhvilluara sidomos në komunitete të varfra, me kushte jetese të papërshtatshme, si dhe me një akses të kufizuar në shërbimin shëndetësor. Një nga kushtet për të marrë shërbim shëndetësor pa pagesë dhe në kohë është zotërimi i librezës shëndetësore. Anketa tregon se rreth 50% e romëve të përfshirë në studim nuk zotërojnë librezë shëndetësore, gjë që bart pasojat të shumfishta lidhur me aksesin në shërbim si dhe kujdesin ndaj shëndetit<sup>33</sup>. Një prej pasojave është detyrimi për të paguar marrjen e shërbimit shëndetësor që në situatën e një komuniteti të varfër siç është ai rom mund ta shkurajojë madje dhe ta pamundësojë marrjen e shërbimit. Një pasojë tjetër që lidhet me aksesin në shërbim mund të jetë rritja e pengesave burokratike në mungesë të librezës shëndetësore, e cila e ndërthurur me korrupsionin e lartë në këtë sektor e bën edhe më të zymtë situatën.



33. Kjo përqindje konfirmohet edhe nga studimi UNDP, *Needs Assessment Study on Roma and Egyptians Communities in Albania, 2012* i cili dëshmon se 56% e popullatës romë deklaroi të mos ketë librezë shëndetësore


Më tej anketa u interesua rreth shpeshtësisë së përdorimit të shërbimit shëndetësor nga pupullata rome e përfshirë në studim. Nga anketa rezulton se rreth 12% e personave të pyetur deklarojnë të mos kenë vizituar asnjëherë gjatë vitit 2012 ndonjë qendër shëndetësore apo spital, kjo e ndjekur nga 44% e personave të pyetur, të cilët deklarojnë të kenë shkuar nga 4 deri ne 10 herë në qendra shëndetësore apo spitale gjatë vitit të shkuar.



Kjo shifër tregon se një pjesë e mirë e komunitetit rom priret ta përdorë shërbimin shëndetësor, por njëkohësisht dëshmon se ky komunitet ose preket shpesh nga shqetësime shëndetësore ose që shërbimi shëndetësor nuk arrin të trajtojë në kohë shqetësimet e pacientëve romë, gjë që rrit pashmangshmërisht numrin e vizitave në institucionet shëndetësore. Një hamendësim i tillë konfirmohet edhe nga studimi më i fundit i UNDP-së, ku të pyetur se nëse mjekët i trajtojnë njësoj romët sikundër edhe pjesën tjetër të popullatës, 33% e pjestarëve të komunitetit rom përgjigjen negativisht<sup>34</sup>.

34. UNDP., Needs Assessment Study on Roma and Egyptians Communities in Albania, 2012

GRAFIKU 3.12. A kujdesen mjekët për ju njësoj si për mazhorancën? (Në përqindje)



Për të hulumtuar prirjen që ekziston brenda komunitetit rom për të marrë shërbimin shëndetësor në rast nevojë, romët e përfshirë në studim u pytetën nëse në rast të shqetësimeve shëndetësore vetjake apo të një familjari ata kërkonin ndihmën e institucioneve shëndetësore. Kështu nga vetëdeklarimet rezultoi se rreth 89% e të pyeturve pranojnë që kërkojnë ndihmën e shërbimit shëndetësor në një rast të tillë, e ndjekur kjo nga rreth 11% e të pyeturve, të cilët mohojnë një gjë të tillë. Ky rezultat tregon se gatishmëria e pjesës dërrmuese të komunitetit rom për të marrë trajtim shëndetësor në rast nevojë është mjaft e lartë, ndërkohë që burokracia apo ato faktorë që lidhen me korrupsionin dhe me raste të diskriminimit përbëjnë pengesa të rëndësishme në marrjen e një shërbimi shëndetësor të plotë dhe cilësor.

Vitet e fundit organizata të shoqërisë civile në bashkëpunim me institucione shëndetësore kanë zbatuar nisma të cilat synojnë lehtësimin e marrjes së shërbimit shëndetësor, si dhe afrimin e tij sa më pranë vendbanimeve të komunitetit rom, sidomos në rastet e atyre informale, të cilat goditen më dendur nga probleme shëndetësore, si dhe aty ku prirja e banorëve për të vizituar institucionet shëndetësore është më e ulët. Këto nisma, edhe pse mjaft inovative, mbeten ende të izoluara në zona të caktuara sikundër dhe përballen me pasigurinë e mbështetjes financiare. Nisur nga kjo është me rëndësi të veçantë si në perspektivën e përmbushjes së të drejtave të njeriut, por edhe në atë të garantimit të

sigurisë së shëndetit publik, që politikbërësit të ndërrmarin nisma të tilla proaktive për të mbuluar të gjithë qytetarët me shërbim shëndetësor sidomos në rastet e familjeve rome që jetojnë në periferi urbane të pazhvilluara, në kushtet e informalitetit dhe varfërisë.


## Strehimi

Shëndeti, arsimi, punësimi dhe mirëqenia kanë një ndërlidhje të fortë me kushtet e strehimit. Pikërisht strehimi, si pasojë e lëvizjeve të shumta demografike në kërkim të burimeve të jetesës, të ardhurave të pakta dhe aksesit ekstremisht të ulët në programet e strehimit social është dhe një nga problemet më serioze me të cilat përballet në pjesë e mirë e komunitetit rom. Për më tepër raportime të shumta dhe vizita në terren tregojnë se në zona të mëdha urbane numri i banesave informale pa perspektivë legalizimi është mjaft i lartë. Ky status i pafavorshëm për banesat e një pjese të komunitetit rom shënon një perspektivë strehimi mjaft të zymtë dhe vazhdimisht të kërcënuar nga planet urbanistike, investimet publike në infrastrukturë apo etja e kompanive të ndërtimit për të zgjeruar investimet e tyre. Gjatë viteve të fundit kemi parë sesi paradoksalisht përpjekjet për të zhvilluar qytetet kanë vënë në rrezik mirëqënien dhe të drejtën për strehim të familjeve rome përmes shpërnguljeve të detyruara. Strehimi ka qenë sektori më pak rezultativ që ka të bëjë me zbatimin e planit të veprimit të dekadës rome në Shqipëri.

Sipas rezultateve të anketës përdorimi dhe aksesit në programet e strehimit social nga komuniteti rom është mjaft i ulët. Vetëm 34% e të intervistuarve nga ky komunitet pohojnë se ekziston një institucion që ofron këtë shërbim në zonën ku ata banojnë dhe vetëm 4% e të gjithë kampionit të anketuar pranon ta përdorë këtë shërbim.

Sipërfaqja e banimit përbën një aspekt të rëndësishëm të standardit të jetesës i rregulluar, gjithashtu, edhe nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.814, datë 3.12.2004 “Për normat e strehimit”, i cili shprehet se: “Sipërfaqja minimale e banimit, që i takon një personi të vetëm, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, është 12.5 m<sup>2</sup>. Çdo personi tjetër shtesë mbi të parin, me moshë mbi 10 vjeç, i takon 7.5 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, ndërsa çdo personi tjetër shtesë me moshë nga 5 vjeç deri në 10 vjeç i takon 3.75 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi.”


Sipas rezultateve të anketës rreth 35% e familjeve rome jetojnë në banesa deri në 40 m<sup>2</sup>, një sipërfaqe kjo mjaft e vogël në rast se do t'i referoheshim faktit që një familje rome ka mesatarisht 4.8 anëtarë, pothuajse një anëtar më shumë se mesatarja e vendit<sup>35</sup>. Situata vështirësohet më tej nëse marrim parasysh faktin që rreth 31% e banesave shfrytëzohen nga dy apo më shumë kurora.



Nëse do t'u referoheshim normave të strehimit për anëtar, gjëndja paraqitet mjaft e vështirë. Sipas një llogarie të thjeshtë nga vendimi i këshillit të ministrave kuptohet se për të përmbushur normat minimale të sipërfaqes së banimit një familje me katër anëtarë, dy prej të cilëve të rritur (prindërit), me një fëmijë mbi 10 vjeç dhe një tjetër nën 10 vjeç, duhet të ketë një normë strehimi rreth 31 m<sup>2</sup> me një mesatare prej 7.8 m<sup>2</sup> për person. Nëse vërehen të dyja grafiqet, ai i sipërfaqes së banesës për familje dhe ai i sipërfaqes për anëtar, duket qartë se minimalisht 19% e familjeve rome qëndrojnë larg nga ky standard strehimi fare minimal dhe nëse marrim në konsideratë madhësinë mesatare të një familje rome me 4.8 anëtarë, si dhe rastet e shumta të banesave që shfrytëzohen nga dy dhe më shumë kurora, situata paraqitet edhe më e errët.

35. 3.9 anëtarë për familje sipas rezultateve të përfundimit të Census 2011. Burimi: INSTAT

GRAFIKU 3.14. Sipërfaqja e banesës për frymë (Në përqindje)



Fatkeqësisht, për shkak të situatës së vështirë ekonomike, përjashtimit të gjatë ekonomik dhe social, si dhe pamundësisë faktike të një pjese të komunitetit për të përmbushur kriteret zyrtare për të përfituar nga programet e strehimit social, perspektiva e strehimit të komunitetit rom paraqitet mjaft e zymtë. Pamundësia e komunitetit rom për të përfituar nga programet sociale përfaqëson një tregues të qartë të pabarazisë sociale dhe të paafetësisë së politikbërësve për t’iu përgjigjur me politika sociale realitetit dhe nevojave konkrete të grupeve më të varfra dhe vulnerabël të shoqërisë. Një analizë e thjeshtë e ligjit për programet e strehimit social<sup>36</sup> dëshmon se ajo pjesë e komunitetit rom, e cila ka nevoja urgjente për strehim, por që të ardhurat e saj i siguron nga veprimtari ekonomike informale, nuk mund të përfitojë nga programi i banesave sociale pasi nuk mund të vërtetojë të ardhurat dhe për rrjedhojë nuk mund të përfitojë kredi bankare<sup>37</sup>. Një pamundësi e ngjashme haset edhe sa i përket programit të qirave sociale, të cilat, sipas legjilacionit, mund të subvencionohen deri

36. Ligj 54/2012 per amendimin e ligjit 9232:

<http://qpz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%2054%20Dat%C3%AB%2010-05-2012.htm>


Ligj 9232:

<http://qpz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%209232%20Dat%C3%AB%2013-05-2004.htm>

37. Sipas anketës rreth 40% e familjeve rome deklarojnë se të ardhurat kryesore familjare i sigurojnë përmes veprimtarive ekonomike informale

në masën 50% nga qeveria vendore. Kjo mbështetje realizohet me kusht që familja përfituese të ketë të ardhura në atë masë që mbulimi financiar i detyrimit të qirasë të mos kalojë më shumë se 25% të të ardhurave mujore të familjes, kriter që nuk mund të plotësohen nga të paktën 45% e familjeve rome, të cilat gjatë anketës kanë deklaruar se sigurojnë më pak se 15,000 lekë të ardhura në muaj.

Situata e strehimit të komunitetit rom paraqitet edhe më qartë nga grafiku i mëposhtëm, i cili tregon se të paktën 18% e familjeve rome jetojnë në barraka dhe kasolle në kushte jetese mjaft të vështira dhe pa asnjë mundësi për t'u legalizuar.



Një përqindje kaq e lartë dhe e pafavorshme bëhet edhe më e prekshme nëse e krahasojmë me përqindjen e banesave të pazakonta/lloj tjetër banese, të identifikuar nga Censusi 2011, të cilat në total ishin rreth 0.003% e banesave në të gjithë territorin e vendit. Krahasimi me rezultatet e Censurit tregon se shtrirja, pesha dhe thellësia e problematikës së strehimit të komunitetit rom është shumë më e mprehtë krahasuar me atë të popullatës së përgjithshme. Gjithashtu, lagje të tëra të komunitetit rom të gjendura në periferi të qendrave të banuara urbane, të palegalizuara dhe në një gjëndje të mjerë infrastrukturore, sugjerojnë një pamje dhe prespektivë të zymtë. Kjo situatë kërkon një zgjidhje të shpejtë, e cila mund të sigurohej përmes shfrytëzimit të progamit të pajisjes së truallit

me infrastrukture urbane, i cili parashikohet në ligjin për programet sociale të strehimit. Shfrytëzimi i një mundësie të tillë vlerësohet deri diku i favorshëm pasi një pjesë e mirë e vendbanimeve informale romë janë të vendosura në tokë publike. Pajisja e tyre me infrastrukturë dhe më pas legalizimi i banesave do të garantonte infrastrukturën minimale (furnizim me ujë të pishëm, kanalizime, ndricim), si dhe siguri të mjaftushme për familjet, institucionet publike, por edhe donatorët e huaj për të investuar gradualisht në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës.


Strehimi përbën një çështje mjaft serioze pasi mungesa apo papërshtatshmëria e tij vë në rrezik të hapur investime të shumta të realizuara përgjatë viteve në mbështetje të arsimimit të komunitetit rom, si dhe kërcënon drejtëpërdrejt shëndetin dhe mirëqënin e këtij komuniteti.





# 04 **Plani i masave VS buxheti për periudhën 2013-2015**

Mungesa e burimeve të financimit dhe koordinimi i pamjaftueshëm i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor dhe qendror janë konsideruar si dy nga shkaqet kryesore për mos zbatimin e strategjisë, të masave të përfshira në Planin Kombëtar të Veprimit për Dekadën Rome dhe të rekomandimeve të seminarit të dhjetorit 2011



## Përmbledhje ekzekutive

Në 15 Dhjetor 2011 u organizua në Tiranë seminari për përfshirjen e Komuniteteve Rome dhe Egjiptianë në Shqipëri nën kujdesin e Pierre Mirel, Drejtor për Zgjerimin i Komisionit Evropian. Mbështetur në situatën aktuale të këtyre komuniteteve dhe diskutimeve në seminar u konkludua me disa rekomandime. Rekomandimet përfundimtare<sup>38</sup> të seminarit për përfshirjen e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri përfshijnë fushat e mëposhtme:

- Çështjet e ndërlidhura-rekomandime të përgjithshme
- Regjistrimi në gjendjen civile
- Arsimi
- Kujdesi social dhe shëndetësor
- Formimi profesional dhe punësimi
- Strehimi dhe infrastruktura

Mungesa e burimeve të financimit dhe koordinimi i pamjaftueshëm i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor dhe qendror janë konsideruar si dy nga shkaqet kryesore për mos zbatimin e strategjisë, të masave të përfshira në Planin Kombëtar të Veprimit për Dekadën Rome dhe të rekomandimeve të seminarit të dhjetorit 2011.

Raporti analizon financimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të seminarit mbi Romët dhe Egjiptianët në programin buxhetor afatmesëm 2013-2015, si dhe paraqet në mënyrë të detajuar i) produktet e programeve buxhetore nën këndvështrimin e planit të veprimit; ii) financimin e aktiviteteve të planit të veprimit sipas sektorëve për periudhën 2012-2015; iii) masën e financimit të planit të veprimit për periudhën 2013-2015.

Analiza për përgatitjen e këtij dokumenti bazohet në programin buxhetor afatmesëm, i rishikuar, 2013-2015, në dokumentin e projekt-buxhetit të vitit 2013 të përgatitur nga Ministria e Financave dhe të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dala nga seminari i dhjetorit 2011. Raporti nuk reflekton financimin e atyre masave që zbatohen nga projektet e donatorëve dhe nuk pasqyrohen në buxhetin e vitit 2013 dhe programin buxhetor afatmesëm si financime të huaja.

---

38. <http://www.mpcs.gov.al/component/content/article/46-rekomandime/767-rekomandimet-perfundimtare>

### Konkluzionet kryesore:

- MPÇSSHB-ja ka bërë përpjekje për të planifikuar produkte specifike për komunitetin rom dhe egjiptian kryesisht në fushën e mbrojtjes sociale dhe monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit të Dekadës (PVD).
- Një pjesë e madhe e masave të planit të veprimit janë parashikuar të zbatohen nga projekte të financuara dhe zbatuara nga donatorë të ndryshëm. Në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) nuk konstatohet që të planifikohet ndërhyrje me financime të qeverisë pas përfundimit të këtyre projekteve.
- Ministritë e tjera nuk kanë planifikuar sa dhe si duhet produkte të veçanta për komunitetin rom dhe egjiptian në programin buxhetor afatmesëm 2013-2015.
- Ka shumë masa në planin e veprimit që parashikohen të zbatohen me buxhetet që institucionet kanë në dispozicion (të përfshira në kategorinë kosto administrative). Për qëllime të monitorimit dhe raportimit është shumë e vështirë që të vlerësohen fondet e alokuara për këto masa.
- Fondet IPA janë instrumenti që aktualisht ka mundësuar financimin e projekteve për komunitetin rom dhe egjiptian. Ky instrument është përdorur nga MPÇSSHB-ja në bashkëpunim me ministri të tjera dhe komunitetin e donatorëve.

## Hyrje

Më 15 dhjetor 2012 u organizua në Tiranë seminari për përfshirjen e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri nën kujdesin e Pierre Mirel, Drejtor për Zgjerimin i Komisionit Evropian. Rekomandimet përfundimtare<sup>39</sup> të seminarit për përfshirjen e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri sipas fushave respektive janë si mëposhtë:

### Çështjet e ndërlidhura-rekomandime të përgjithshme

- Deri tani janë miratuar mjaft masa të rëndësishme në drejtim të avancimit të përfshirjes së grupeve vulnerabël, ku përfshihen komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Autoritetet janë inkurajuar të bëjnë përpjekje shtesë në drejtim të zbatimit të politikave ekzistuese duke përfshirë Planin e Veprimit të Dekadës së Romëve dhe Strategjinë Kombëtare të Përfshirjen Sociale. Ka nevojë të rritet alokimi i burimeve financiare në nivel qendror dhe vendor. Duhet bërë alokime të veçanta buxhetore për sigurimin e shërbimeve me rendësi kritike për Romët. Duhet angazhuar në mënyrë aktive grupi ndërministror i punës për Romët dhe grupi ndërministror i punës për përfshirjen sociale.
- Përforsimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut për Romët përbën një ndër prioritetet kyçe të Opinionit për kërkesën e Shqipërisë për anëtarësimin e saj në BE dhe, për rrjedhojë, është element i domosdoshëm për progresin e mëtejshëm në rrugën e integritimit në BE. Shqipëria inkurajohet që të përdorë plotësisht instrumentet financiare të tilla si IPA në kuadër të përpjekjeve të saj për të arritur përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël. Për shembull, masat e parashikuara në kuadër të përgatitjes për Programin Operacional të IPA-s për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore duhet të tregojnë si përparësi përfshirjen sociale për të gjithë qytetarët vulnerabël.
- Sekretariati Teknik i Romëve, si dhe autoriteti i tij duhet forcuar nëpërmjet alokimit të burimeve shtesë njerëzore dhe financiare në mënyrë që të luajë rolin e tij monitorues dhe koordinues në mënyrë më efektive.
- Duhet rritur ndërgjegjësimi i atyre që janë të ngarkuar me zbatimin

---

39. <http://www.mpcs.gov.al/component/content/article/46-rekomandime/767-rekomandimet-perfundimtare>

e politikave në nivel vendor. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të alokojnë buxhet për zbatimin e politikave specifike. Duhet hartuar plane të nivelit vendor për zbatimin e politikave që shënjestrojnë grupet më vulnerabël dhe përgjegjësitë duhet decentralizuar në mënyrë të qartë.

- Shërbimet relevante duhet të garantojnë që të dhënat që mblidhen nga të gjitha organizatat përgjegjëse të jenë të besueshme dhe të lehta për t'u përdorur nga politikëbërësit. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta inkurajohet të garantojë drejtim efikas dhe qëndrueshmëri të Sistemit të Bazuar në Rrjet (web) të Planit Kombëtar të Veprimit të zhvilluar në bashkëpunim me PNUD-in me qëllim që të garantohet mbledhja, raportimi dhe administrimi efikas i të dhënave.
- Autoritetet Shqiptare në nivel qendror dhe vendor duhet të angazhojnë në mënyrë aktive organizatat e shoqërisë civile që punojnë me organizatat e komuniteteve vulnerabël Rome dhe Egjiptiane në fushën e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave në nivel qendror dhe vendor.
- Programet mbështetëse dhe masat e zbatuara nga autoritet në nivel qendror dhe vendor duhet të monitorohen, koordinohen dhe vlerësohen në mënyrë sistematike për të garantuar efektshmërinë dhe efikasitetin e tyre.
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë, si dhe e ofruesve të shërbimeve private/publike për çështjen e mosdiskriminimit dhe të bashkëjetesës është e domosdoshme për të siguruar kohezionin social dhe për t'u dhënë fund të gjitha praktikave diskriminuese. Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të garantuar zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në të gjitha fushat në lidhje me komunitetet Rome dhe Egjiptiane.
- Media duhet të nxitet të ofrojë imazhe pozitive të personave Romë dhe Egjiptianë, duke përfshirë nxitjen nëpërmjet trajnimeve për gazetarët mbi çështjet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirjes sociale dhe anti-diskriminimit.
- Roli i nëpunësve publikë që punojnë në shërbimet sociale duhet zgjeruar nëpërmjet modifikimit të përshkrimit të punës së tyre dhe rritjes së përgjegjësisë për të mundësuar angazhimin efikas të tyre me familjet dhe fëmijët vulnerabël nëpërmjet punës në komunitet dhe vizitave në shtëpi. Në këtë kuadër, autoritet shqiptare duhet

të vazhdojnë të punojnë për këtë çështje me aktorët relevantë të interesit duke përfshirë këtu organizatat e shoqërisë civile, agjencitë e OKB-së dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

### Regjistrimi në gjendjen civile

- Shqipëria duhet të garantojë se maternitetet dhe spitalet duhet të përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me regjistrimin e lindjeve dhe raportimin e tyre në mënyrë efikase dhe sistematike, duke u lidhur më Njësitet e Qeverisjes Vendore dhe Zyrat e Gjendjes Civile, duke përfshirë rastet kur një fëmijë lind nga një nënë e paregjistruar. Një vëmendje e veçantë u duhet kushtuar fëmijëve të lindur jashtë materniteteve. Asnjë fëmijë nuk duhet të jetë subjekt i boshllëqeve dhe të mbetet i paregjistruar, meqenëse regjistrimi i lindjes përbën portën kryesore drejt aksesit ndaj të gjitha shërbimeve sociale dhe të drejtave civile.
- Rastet e fëmijëve të lindur jashtë vendit dhe të atyre që nuk kanë marrë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm duhet të ndiqen në mënyrë aktive nga Zyrat Konsullore, në bashkëpunim të ngushtë me aktorët relevantë të interesit, duke përfshirë këtu organizatat e shoqërisë civile, agjencitë e OKB-së, dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.
- Autoritetet vendore shqiptare dhe zyrat e gjendjes civile duhet të angazhohen me shoqatat e dhe komunitetet vendore të Romëve dhe të Egjiptianëve për të parandaluar martesat në moshë të hershme me qëllim që të ulen rastet e lindjeve të paregjistruara.
- Ministria e Brendshme, Drejtoria e Gjendjes Civile dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta duhet të lidhen me organizatat e shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë dhe me udhëheqësit e komunitetit të organizojnë së bashku sesione informimi për të shpjeguar përfitimet që vijnë nga regjistrimi dhe të garantojnë kushte për identifikimn e rasteve të parregjistruara
- Ligji për ndihmën ligjore falas duhet të zbatohet në mënyrë efikase. Komisionit Shtetëror për Ndhmën Ligjore i duhet alokuar buxhet, për të garantuar, në këtë mënyrë, aksesin në drejtësi për grupet dhe njerëzit vulnerabël në vijim të regjistrimit pasues. Individët që përfitojnë nga ndihma ligjore falas duhet të përjashtohen nga shpenzimet që lidhen me procedurat gjyqësore dhe administrative.
- Regjistrimi në gjendjen civile nuk duhet kushtëzuar me pagimin



e taksave vendore. Kostoja e testit të ADN-së për fëmijët, që ata të ribashkohen me të afërmit e tyre, duhet mbuluar nga autoritetet shtetërore.

- Skema financiare për regjistrimin e hershëm të lindjeve (përpara afatit 60- ditor) duhet zbatuar në mënyrë efikase dhe burimet duhen alokuar në përputhje me rrethanat.

## Arsimi

- Duhet bërë përpjekje të tjera të fuqishme në fushën e arsimit për grupet vulnerabël, në mënyrë të veçantë për fëmijët Romë dhe Egjiptianë. Është e nevojshme të ngrihen njësi shtesë të integruara publike para-shkollore dhe kopshte në të gjithë territorin e vendit për të punësuar arsimtare dhe edukatorë për të mundësuar mësimin më nga afër të fëmijëve në vështirësi. Politika e braktisjes zero për fëmijët në moshën e arsimit të detyrueshëm duhet zbatuar plotësisht.
- Drejtuesit dhe psikologët e shkollave duhet të luajnë një rol aktiv në lidhje me garantimin e regjistrimit të vazhdueshëm të fëmijëve të familjeve vulnerabël. Shkollat duhet të japin llogari për fëmijët në zonën e tyre dhe duhen krijuar lidhjet me njësitë e mbrojtjes së fëmijëve.
- Duhet garantuar zbatimi efikas i politikave ekzistuese për kujdesin ndaj arsimimit të fëmijëve Romë dhe Egjiptianë dhe duhen trajtuar mangësitë e këtyre programeve, të tilla si për shembull: garantimi i funksionimit efektiv të sistemit për dhënien falas të teksteve mësimore për fëmijët në nevojë.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të sigurojë ndihmë të mëtejshme për të rinjtë romë dhe egjiptianë që ata të vazhdojnë studimet universitare duke zbatuar, ndër të tjera, në mënyrë efikase kuotat ekzistuese. Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të bëjë përpjekje, gjithashtu, për të punësuar të diplomuarit romë dhe egjiptianë si mësues në mënyrë që të paraqesë modele të roleve pozitive për të gjithë fëmijët e përkatësive të tjera.
- Prindërit duhen bërë më të përgjegjshëm për fëmijët e tyre, dhe përfaqësuesit e komunitetit dhe shoqatat kanë një rol shumë të rëndësishëm për të luajtur me prindërit. Ndjekja e institucioneve arsimore nga fëmijët në moshë shkollore duhet konsideruar si një nga kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike.

## Kujdesi social dhe shëndetësor

- Funksionet e punonjësve socialë duhet të evoluojnë nga natyra administrative në dhënie të ndihmës në terren për familjet dhe në kryerjen e vizitave në shtëpi.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave që rregullon aksesin e kujdesit shëndetësor duhet ndryshuar në mënyrë që të lejojë akses universal ndaj kujdesit shëndetësor falas, duke përfshirë edhe kujdesin për personat që nuk zotërojnë dokumentacionin e nevojshëm (duke përfshirë këtu, për shembull, fëmijët e rrugës etj.).
- Autoritetet vendore, së bashku me shërbimet sociale, duhet të marrin masat për të trajtuar në mënyrë efektive çështjet e fëmijëve që lypin, nëpërmjet hartimit të planeve specifike të veprimit për të trajtuar shkaqet rrënjësore të problemit, i cili rrjedh nga varfëria.
- Shqipëria duhet të organizojë fushata ndërgjegjësimi për një gamë çështjesh të tilla si higjiena, shëndeti riprodhues, planifikimi familjar, si dhe rreziqet që lidhen me martesat dhe shtatzaninë e parakohshme. Duhet garantuar vaksinimi i të gjithë fëmijëve romë dhe egjiptianë.
- Autoritetet vendore duhet të garantojnë respektimin e akteve ligjore ekzistuese për trajtimin e mbetjeve, në mënyrë që të gjitha impiantet vendore të përpunimit të mbetjeve të rrethohen, që të parandalohet veprimtaria e rrezikshme e mbledhjes së mbeturinave nga këto pika, në mënyrë të veçantë nga fëmijët.

## Formimi profesional dhe punësimi

- Programet e formimit profesional duhen orientuar në drejtim të përfitimit nga personat që trajnohen si dhe nga nevojat e tregut. Ata duhen pajisur me certifikata formimi profesional të njohura në shkallë vendi dhe me akses në tregun e punës në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të qytetarëve.
- Shkollat dhe qendrat e arsimit dhe formimit profesional duhet të krijojnë një lidhje me punëdhënësit nga sektori publik dhe privat.
- Shteti duhet të japë shembullin pozitiv për punëdhënësit privatë duke punësuar persona nga komunitetet Romë dhe Egjiptiane në të gjitha nivelet e përgjegjësisë, në nivel qendror dhe vendor, duke shënjestëruar arsimin, shërbimet e kujdesit shëndetësor/social dhe regjistrimin në gjendjen civile në radhë të parë.
- Zyrtat Publike të Punësimit duhet të luajnë një rol aktiv në këshillimin e punësimit dhe krijimin e lidhjeve ndërmjet qendrave të formimit profesional dhe punëdhënësve privatë.

- Njëpërmjet Politikave Aktive të Tregut të Punës dhe Masave Aktive të Tregut të Punës dhe punëve publike, Qeveria Shqiptare duhet të zbatojë politika aktive punësimi për romët dhe egjiptianët duke u fokusuar në punësimin me pagë.

### Strehimi dhe infrastruktura

- Autoritetet vendore duhet të organizojnë në mënyrë sistematike konsultime me komunitetet e prekura përpara se të kryejnë një risistemim ose shvendosje të ngulimeve informale. Në rast zhvendosjeje, duhet të jetë e detyrueshme për autoritetet vendore që të sigurojnë strehim zëvendësues për të gjithë personat e prekur.
- Autoritetet Shqiptare, njëpërmjet koordinimit ndërmjet nivelit qendror dhe vendor, duhet të garantojnë gjetjen e zgjidhjeve ligjore dhe praktike në progresion për komunitetet Rome dhe Egjiptiane që jetojnë aktualisht në ngulime informale të cilat nuk janë të legalizueshme.
- Në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore duhen zbatuar kritere të qarta dhe realiste, që mundësojnë paraqitjen e kërkesave dhe procedurat transparente për dhënie të strehimit social për grupet më vulnerabël. Programe strehimi specifike dhe të përshtatura për këtë kategori, të cilat respektojnë diversitetin kulturor dhe evitojnë dallimet sociale duhet të implementohen gradualisht për grupet në nevojë
- Qeveria duhet të garantojë akses ndaj ujit të pastër dhe pastërtisë në zonat ku janë të pranishme komunitetet Rome dhe Egjiptiane.
- Qeveria duhet të sigurojë që familjet rome, që janë zhvendosur nga stacioni i trenit në Tiranë në shkurt të vitit 2011, të përfitojnë alternativa strehimi të përshtashme.

Në raportin e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë ndër të tjera theksohet: “Zbatimi i strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës, Plani Kombëtar i Veprimit për Dekadë Romëve dhe konkluzionet operacionale të seminarit të dhjetorit 2011 për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në kuadrin e integrimit në BE të Shqipërisë vazhdon të jetë shumë i ngadaltë, për shkak të burimeve të pamjaftueshme dhe koordinimit të pamjaftueshëm të institucioneve të përfshira në nivel vendor dhe qendror<sup>40</sup>.

40. EU Progres report 2012. fq. 22

## Plani i veprimit dhe PBA 2013-2015

- Në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve parashikohet planifikimi dhe rritja e fondeve buxhetore të veçanta për zbatimin e politikave të veçanta për romëtdhe egjiptianët nga ana e ministrive të linjës. MPÇSSHB-ja ka parashikuar në PBA produkte specifike për komunitetin rom në lidhje me mbrojtjen sociale (trajtimi me ndihmë ekonomike dhe pagesën e aftësisë së kufizuar), shpenzimet për monitorimin e Dekadës së Përfshirjes së Romëve dhe tregun e punës (programi i nxitjes së punësimit).
- Ministria e Arsimit dhe Shkences (MASH) parashikon si masë të veçantë kompensimin për tekstet shkollore, por kjo masë nuk është e veçantë për nxënësit romë dhe egjiptianë, ajo përfshin një kategori më të gjerë përfituesish.
- Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT), Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Ministria e Brendshme (MB) nuk kanë reflektuar në programin buxhetor afatmesëm fonde buxhetore të veçanta për zbatimin e politikave specifike për komunitetin rom dhe egjiptian.
- MPÇSSHB-ja ka parashikuar në PBA si produkt të veçantë monitorimin e zbatimit të objektivave të strategjise ndërsektoriale të përfshirjes sociale dhe ka alokuar fonde për periudhën 2013-2014. Fondet për vitin 2014 janë parashikuar të rriten me 34% në krahasim me vitin 2013.
- MB-ja ka parashikuar në PBA fonde buxhetore për trajnimin e nëpunësve të administratës publike. Numri i personave që përfitojnë trajnime është planifikuar në 3000 për secilin vit buxhetor (2012-2015), por në PBA nuk ka specifikime se sa do të jetë buxheti që do të përdoret për ofrimin e trajnimeve për rritjen e kapaciteve për hartimin e projekteve IPA. Buxheti për trajnime rritet mesatarisht me 0.5% çdo vit.
- Disa masa për të cilat është përgjegjëse MPÇSSHB-ja janë planifikuar të financohen nga projekti i PNUD-it, Këshillit të Evropës dhe OSBE-së dhe nuk reflektohen në PBA.
- Fondet e alokuara për monitorimin dhe koordinimin e çështjeve të përgjithshme nga STR-të rriten me 35.4% për vitin 2013, por ato planifikohen më të ulta për periudhën 2014-2015.
- Trajnimi i romëve të papunë nuk përbën një program specifik për romët. Ky program ofrohet për të gjithë punëkërkuarit e papunë, por është specifikuar që 35% e përfituesve duhet të jenë nga grupet vulnerabël.
- MASH-i ka planifikuar si produkt të veçantë dhënien e bursave për nxënësit në nevojë, ku përfshihet edhe komuniteti rom dhe egjiptian.

Numri i planifikuar i përfituesve është 4800 nxënës çdo vit. Buxheti për këtë produkt ulet me 2.8% për vitin 2013 dhe rritet respektivisht me 4.5% dhe 6.8% për vitet 2014 dhe 2015. MASH nuk e ka të specifikuar se sa do të jetë numri i përfituesve nga komuniteti rom dhe egjiptian.

- MASH planifikon trajnimin e psikogëve si një produkt të veçantë në PBA. Numri i personave të trajnuar është 250 çdo vit (2012-2015) dhe shpenzimet totale janë të njëjta (2,500,000 lekë).
- Shumë masa të planifikuara për t'u zbatuar nga MASH-i kanë të bëjnë me aktivitetin e përditëshëm të institucioneve arsimore në nivel vendor apo në shkolla dhe buxheti që ato shpenzojnë për të zbatuar aktivitetet e planit të veprimit nuk mund të veçohet nga shpenzimet e përgjithshme.
- Aktivitetet e dedikuara për nxënësit romë dhe egjiptianë janë kryesisht të financuara nga donatorët dhe zbatohen nga organizata ndërkombëtare si UNICEF, Save the Children apo OJF lokale. Këto shpenzime mund të gjurmohen vetëm përmes raporteve të projekteve dhe nuk reflektohen në PBA apo buxhetin vjetor. Në këto raste institucionet arsimore janë vetëm lehtësuese dhe përfituese të projekteve.
- MB nuk ka planifikuar produkte të veçanta për komunitetin rom dhe egjiptian në programin buxhetor afatmesëm.
- Disa aktivitete të planifikuara në lidhje me regjistrimin mbulohen nga fondet e donatorëve ose janë planifikuar të mbulohen nga kostot administrative. Për këto raste është e vështirë të llogaritet se sa shpenzohet nga buxheti për zbatimin e tyre dhe nëse këto aktivitete janë të mbuluara ose jo.
- MSH nuk ka produkte të veçanta për komunitetin rom dhe egjiptian në programin buxhetor afatmesëm.
- Të gjitha aktivitetet e planifikuara në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve përfshihen në ndërhyrjet në nivel kombëtar, që bëhen nga MSH-ja dhe institucionet e varësisë dhe është e vështirë të ndahen fondet për romët dhe egjiptianët. Kjo mund të realizohet vetëm përmes monitormit dhe mbledhjes së statistikave të veçanta për secilin shërbim.
- MPPTT nuk ka parashikuar në PBA ndonjë program të veçantë për projekte infrastrukturore për të përmirësuar kushtet e jetesës për komunitetin rom dhe egjiptian.
- MPPTT ka planifikuar realizimin e studimit dhe përfundimin e projekteve për mbylljen e vend-depozitimeve ekzistuese në Elbasan, Vlorë, Durrës dhe Sarandë gjatë vitit 2013. Gjithashtu, për periudhën 2013-2015 është planifikuar fillimi i punimeve për ndërtimin e vend-depozitimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Elbasanit dhe përfundimi i vend-depozitimit të mbetjeve të ngurta në qarkun e Korçës.

## Alokimi i burimeve financiare sipas sektorëve

**Arsimi** - Shpenzimet për kompensimin e teksteve shkollore janë planifikuar në të njëjtin nivel për periudhën 2012-2014. Vetëm në vitin 2015 ato planifikohen të rriten me 0.5%. Në këtë linjë produkti përfaqësohet kompensimi i teksteve shkollore për nxënësit e arsimit bazë, përgatitja e teksteve shkollore dhe kompensimi i shtresave sociale në nevojë, romë, egjiptianë, me aftësi të kufizuara, nxënës jetimë, pakicat kombëtare. Rritja e treguesit të regjistrimit me 4.5% ose 180 nxënës romë dhe egjiptianë është një ndër objektivat e këtij produkti. Me të dhënat e PBA-së konstatohet vetëm që nxënësit romë dhe egjiptianë mund të përfitojnë nga kjo skemë kompensimi, por nuk mund të përcaktohet se në ç'masë përfitojnë ata në raport me totalin dhe sa është numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që planifikohen të përfitojnë në vite. Shpenzimet për një nxënës janë mesatarisht 550 lekë.

**Tabela 1: Kompensimi i teksteve shkollore (në mijëra lekë)**

	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2013-2015		
	2012	2013	2014	2015
Totali i Shpenzimeve	210,000.0	210,000.0	210,000.0	217,500.0

Burimi : PBA Ministria e Financave 2013-201, fq. 45

**Favorizimi i nxënësve në nevojë** - Ndër politikat favorizuese sociale MASH-i planifikon dhënien e bursave. Nga ky program përfitojnë kryesisht nxënësit në arsimin e mesëm. Ky nuk është një produkt i veçantë për komunitetin rom dhe egjiptian, por ata mund të përfitojnë prej tij bazuar në procedurat e përcaktuara nga MASH-i. Për vitin 2013 parashikohet një rënie në masën 2.8% e shpenzimeve të planifikuara për bursa, ndërkohë që këto shpenzime planifikohen më të larta për vitet 2014-2015. Rritja e shpenzimeve shkaktohet nga rritja e shpenzimeve për njësi (planifikohet një nivel i rritur i bursave), ndërkohë që numri i përfituesve është i njëjtë për të gjithë periudhën 2012-2015 (4800 nxënës).

**Tabela 2: Politika favorizuese sociale (shpenzime për bursa në mijëra lekë)**

	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2013-2015		
	2012	2013	2014	2015
Totali i Shpenzimeve	143,718.0	139,660.0	146,000.0	156,000.0

Burimi : PBA Ministria e Financave 2013-201, fq. 52

**Mbrojtja Sociale** - Aktualisht MPÇSSHB-ja ofron tre produkte që lidhen me ndihmën ekonomike, të cilat janë :

- Gra kryefamiljare që trajtohen me ndihmë ekonomike
- Familje rome që trajtohen me ndihmë ekonomike
- Familje në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike

Familjet rome mund të përfitojnë nga dy skemat e para dhe është planifikuar një mbeshtetje në rritje për këto dy grupe, siç mund të shihet në grafikun nr.3 , ndërkohë që planifikohet një ulje me 16.7% deri në vitin 2015 e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

**Tabela 3: Trajtimi me ndihmë ekonomike (numri i familjeve)**

	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2013-2015		
	2012	2013	2014	2015
Familje në nevojë	81524	76524	71524	67974
Gra kryefamiljare	11000	11000	11500	12000
Familje Rome	1500	1500	1600	1650

Burimi : PBA Ministria e Financave 2013-2015, fq. 253

Numri i familjeve rome që do të trajtohen me ndihmë ekonomike parashikohet të rritet me 10%. Gjithashtu rritje planifikohet në shpenzimet për familjet rome për vitet 2014-2015. Rritja më e madhe vihet re në vitin 2014, me respektivisht 12.5%

**Grafiku4: Shpenzimet për familjet Rome (në mijëra lekë)**

	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2013-2015		
	2012	2013	2014	2015
Shpenzime për njësi	51.2	51.2	57.8	60.0

Burimi : PBA Ministria e Financave 2013-2015, fq. 253

Në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të Dekadës Rome është financuar trajtimi me pagesën e aftësisë së kufizuar i individëve romë. Numri i personave që do të trajtohen me këtë pagesë parashikohet të rritet me 17.1% nga viti 2012 në vitin 2015.(shih tabelën 5)

**Tabela 5: Individë romë të trajtuar me pagesën e aftësisë së kufizuar**

	Viti aktual	Numri i planifikuar 2013-2015		
	2012	2013	2014	2015
Numri i individëve	700	750	800	820

Burimi : PBA 2013-2015, fq. 254

Në PBA parashikohet, gjithashtu, rritje e shpenzimeve për njësi dhe shpenzimeve totale për këtë produkt. Tabela 6. na tregon buxhetin e planifikuar për këtë produkt në vite. Në vitin 2012, pagesa vjetore për aftësinë e kufizuar për një individë rom ka qenë 111,600 lekë. Në vitin 2015 ajo është planifikuar të jetë 120,0000. Përqindja e ndryshimit të shpenzimeve për njësi në periudhën 3- vjeçare është mesatarisht 2.5 % në vit.

**Tabela 6: Totali i shpenzimeve për individët romë të trajtuar me pagesën e aftësisë së kufizuar (në mijëra lekë)**

	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2013-2015		
	2012	2013	2014	2015
Totali i shpenzimeve	78,120.0	86,400.0	94,080.0	98,400.0

Burimi : PBA 2013-2015, fq. 254

Shpenzimet totale për individët romë të trajtuar me pagesën e aftësisë së kufizuar janë parashikuar në rritje për të gjithë periudhën 2013-2015. Rritja më e madhe është parashikuar në vitin 2013, me 10.6%.

**Monitorimi** - Shpenzimet e alokuara për Sekretariatit Teknik të Romëve TR për monitorimin e Planit të Veprimit të Dekadës kanë një rritje me 35.4% për vitin 2013. Në vitin 2014 shpenzimet alokohen për hartimin e dokumentit të ri strategjik, ndërsa në vitin 2015 për minitorimin e këtij dokumenti

**Tabela 7: Shpenzimet për monitorimin e Dekadës së Përfshirjes së Romëve (në mijëra lekë)**

	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2013-2015		
	2012	2013	2014	2015
Totali i shpenzimeve	2,127.5	2,880.3	2,509.4	2,573.2

Burimi : PBA 2013-2015, fq. 258

**Nxitja e punësimit**-Shpenzimet e planifikuara për programet e nxitjes së punësimit në vitin 2013 janë planifikuar në të njëjtin nivel me vitin 2012. Në këto programe 35% e shpenzimeve është e dedikuar për grupet në nevojë. Këto shpenzime planifikohen të rriten me 77.7% për vitin 2014 dhe bien përsëri ndjeshëm në vitin 2015.

**Tabela 8: Shpenzimet për programin e nxitjes sëpunësimit (në mijëra lekë)**

	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2013-2015		
	2012	2013	2014	2015
Totali i shpenzimeve	90,000.0	90,000.0	160,000.0	100,000.0

Burimi : PBA 2013-2015, fq. 260-261

**IPA**- MPCSSHB-ja ka planifikuar si produkt të veçantë zbatimin dhe monitorimin e projekteve IPA. Për vitin 2013 shpenzimet planifikohen të rriten me 2.6% dhe për 2014 me 9.7%. Numri i raporteve të prodhura rritet nga 6 në 15.



**Tabela 9 : Shpenzime për zbatimin dhe monitorimin e projekteve IPA (në mijëra lekë)**

	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2013-2015		
	2012	2013	2014	2015
Totali i shpenzimeve	12,678.0	13,010.0	14,275.0	14,040.0

Burimi : PBA 2013-2015, fq. 250

**Strehimi-infrastruktura-** Për periudhën 2012-2015, në investimet e buxhetit të shtetit nuk janë miratuar fonde për përmirësimin e kushteve të jetesës së Komunitetit Rom. MPPTT nuk ka programe të posaçme për romët.

Në PBA janë pasqyruar shpenzimet për strehimin përmes kredive të buta. Ofrohen gjithsej 3 programe me 0, 3 dhe 4 përqind interes për kreditë. Nga këto programe mund të përfitojnë 17% e familjeve që kanë aplikuar pranë bashkive. Nuk ka kuota të veçanta për grupet në nevojë.

**Tabela 10 : Shpenzime për vendosjen e një gjendjeje sigurie në fushat e vend-depozitimeve (në mijëra lekë)**

	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2013-2015		
	2012	2013	2014	2015
Studim dhe projekt i përfunduar për mbylljen e venddepozitimit ekzistues				
Totali i shpenzimeve Elbasan	9,000.0	4,666.0	0.0	0.0
Totali i shpenzimeve Durrës	5,000.0	10,000.0	5,000.0	0.0
Totali i shpenzimeve Sarandë	5,000.0	10,334.0	4,666.0	0.0
Totali i shpenzimeve Vlorë	5,000.0	10,000.0	5,000.0	0.0

## Konkluzione

MPÇSSHJ-ja ka bërë përpjekje për të planifikuar produkte specifike për komunitetin rom dhe egjiptian kryesisht në fushën e mbrojtjes sociale dhe monitorimit të zbatimit të PVD-së.

Një pjesë e madhe e masave të planit të veprimit janë parashikuar të zbatohen nga projekte të financuara dhe zbatuara nga donatorë të ndryshëm. Në PBA nuk konstatohet të jetë planifikuar ndërhyrje me financime të qeverisë pas përfundimit të këtyre projekteve.

Ministritë e tjera nuk kanë planifikuar sa dhe si duhet produkte të veçanta për komunitetin rom dhe egjiptian në programin buxhetor afatmesëm 2013-2015.

Ka shumë masa në planin e veprimit që parashikohen të zbatohen me buxhetet që institucionet kanë në dispozicion (të përfshira në kategorinë kosto administrative). Për qëllime të monitorimit dhe raportimit është shumë e vështirë të vlerësohen fondet e alokuara për këto masa.

Fondet IPA janë instrumenti që aktualisht ka mundësuar financimin e projekteve për komunitetin rom dhe egjiptian. Ky instrument është përdorur nga MPÇSSHJ-ja në bashkëpunim me ministri të tjera dhe komunitetin e donatorëve.

## Referenca

1. Programi Buxhetor Afatmesem , I Rishkuar, 2013 – 2015
2. Buxheti 2013
3. Plan of Measures Following Recommendations of the Seminar on Roma and Egyptian Inclusion Organized on 15 December 2011



**FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË**

*Rr. Qemal Stafa, Pallati 120/2, Tirana, Albania*

*Tel: +355 4 22 34 621 / 22 34 223 / 22 35 856*

*Fax: +355 4 22 35 855*

*E-mail: [info@soros.al](mailto:info@soros.al)*

*Web-page: [www.soros.al](http://www.soros.al)*

